

E drejta për informim në Ballkanin
Perëndimor në vitin 2022:

THIRRJET MBETEN PA PËRGJIGJE

Monitorimi i Transparencës dhe
Proaktivitetit Institucional – Viti i
Tretë

Autori: **Shengjyl Osmani Loxha**

Pasqyra e lëndës

Hyrje	3
Përmbledhje e të drejtës për informim	7
Analiza e Kërkesave të Paraqitura	10
Komisionerët për të drejtën e informimit dhe Avokatët e Popullit	31
Partneriteti për Qeverisje të Hapur	45
Përfundime	52
Rekomandime	58

Hyrje

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative ka monitoruar nga afër të drejtën për informim në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit të kaluar. Ky raport bazohet në një analizë të kërkesave të paraqitura nga gazetarët e BIRN në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, legjislacioni aktual dhe intervistat e kryera me palët përkatëse të interesit. Raporti paraqet një përmbledhje të përvojave të gazetarëve të BIRN në sferën e të drejtës për informim (DI) në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Ky raport mbulon gjetjet e BIRN për vitin 2022 dhe analizon një përzgjedhje të institucioneve nga rajoni, nga ato që u dhanë lirisht informacione gazetarëve të BIRN deri tek ato që nuk e bënë këtë. Ai gjithashtu krahason tre vitet e fundit (2020-2022) dhe nxjerr në pah tendencat e përgjithshme në sferën e të drejtës për informim në Ballkan.

Nga janari deri në dhjetor 2022, gazetarët e BIRN dorëzuan 376 kërkesa për të drejtë informimi (DI). Vetëm 134 morën përgjigje plotësisht; 15 morën përgjigje pjesërisht dhe 14 u refuzuan. Më shumë se gjysma e kërkesave, 213, nuk morën asnjë përgjigje (ajo që njihet si “heshtje administrative”), duke reflektuar mungesën e transparencës dhe proaktivitetit të institucioneve publike. Është e rëndësishme të theksohet se ky nuk është numri i përgjithshëm i kërkesave për DI të paraqitura nga gazetarët e BIRN në gjashtë vendet në vitin 2022; kërkesat e analizuara në këtë raport u dërguan si pjesë e projektit të BIRN “A Paper Trail to Better Governance”, i cili synon të nxisë transparencën institucionale, proaktivitetin dhe llogaridhënien në rajon.

Disa institucione në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë vazhduar të kenë mungesë stafi prej disa vitesh. Kjo do të thotë se, për shembull, nëse zyrtari përkatës në institucionin që merret me kërkesat për DI rezulton pozitiv për

COVID-19, nuk ka një njeri tjetër që t'i japë përparësi këtyre kërkesave dhe të sigurojë respektimin e afateve ligjore. Për më tepër, në Serbi, Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës tha se nuk mund të përpunonte një kërkesë për DI për projektin e Urës së Savës sepse personi përgjegjës kishte rezultuar pozitiv me COVID-19, dhe pavarësisht ndjekësh së kësaj çështjeje dhe riparimit të kërkesave për DI, për gati dy muaj, ministria ofroi vetëm dokumente të pjesshme, pa dhënë asnjë arsye për materialin e munguar. Ngjashëm, kur Kuvendi i Kosovës u pyet për numrin e rasteve pozitive me COVID-19, ai nuk u përgjigj, duke të shpërfillur shqetësimin e publikut për këtë çështje shëndetësore.

Në vitin 2020, institucionet e çdo vendi u detyruan të punonin nën kufizimet e COVID-19 (duke punuar nga shtëpia ose punë hibride). Pothuajse të gjitha vendet nuk ishin të pajisura teknikisht siç duhet, pasi jo shumë të dhëna ishin digjitalizuar, dhe për këtë arsye nuk i përshpejtuan kërkesat për DI (sipas raportit të BIRN për vitin 2020, vetëm 48% e kërkesave tona për DI u miratuan dhe 45% nuk morën asnjë përgjigje). Situata nuk ndryshoi shumë në vitin 2021, pasi vetëm gjysma e kërkesave për të drejtë informimi të BIRN morën përgjigje plotësisht dhe 37% nuk morën asnjë përgjigje.

Në vitin 2022, shumë institucione publike në Ballkanin Perëndimor vazhduan të mos përgjigjen dhe të shpërfillin kërkesat për DI. Edhe pas disa tentativave dhe ankesave, pak kërkesa morën përgjigje plotësisht.

Ligjet për të Drejtën për Informim në Ballkanin Perëndimor ekzistojnë prej më shumë se një dekade, dhe megjithëse pothuajse në të gjitha vendet e monitoruara kanë ligje që konsiderohen të jenë të shkruara mirë, vlera e tyre shpesh është vetëm në letër. Institucionet që u monitoruan në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi vazhdojnë të luftojnë me zbatimin e ligjeve për të drejtën për informim (DI) dhe nuk po arrijnë të bëhen më transparente dhe të përgjegjshme për qytetarët e tyre.

Sipas vëzhguesve dhe organizatave ndërkombëtare të medias, situata në rajon u përkeqësua sërish në vitin 2022 dhe shumica e vendeve kanë shfaqur regres në transparencën, llogaridhënien, lirinë e informacionit dhe demokracinë në përgjithësi.¹

Për më tepër, raportet e progresit të Komisionit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2022 vunë në dukje se situata në lidhje me lirinë e shprehjes dhe qasjen në të dhënat dhe dokumentet publike vazhdon të jetë e kufizuar dhe se nuk është bërë asnjë progres për këtë çështje gjatë vitit.²

Hulumtimi i BIRN dhe raportet rajonale dhe ndërkombëtare në lidhje me DI-në treguan gjithashtu se nuk është bërë asnjë progres gjatë vitit 2022 për lirinë e shprehjes në Ballkanin Perëndimor. Shumë institucione nuk e kishin prioritet qasje në informacion kur merrnin kërkesa nga publiku, disa ndryshime ligjore u diskutuan me dyer të mbyllura, që do të thotë se publiku, organizatat e shoqërisë civile, gazetarët dhe përfaqësuesit e mediave nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë në diskutime. Disa gazetarë nuk ishin në gjendje të përfundonin investigimet e tyre për shkak se qasja në dokumente thelbësore nuk u dha në kohë, ose ata morën përgjigje të pjesshme pas disa muajsh ndjekjeje, të cilat përfshinin vendime të lëshuara nga zyrat e komisionerëve për të drejtën e informimit që u kërkonin institucioneve publike të jepnin informacionin e kërkuar.

Raportet e progresit të Komisionit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2022³ argumentuan gjithashtu se dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjen në informacion janë ende duke u interpretuar në një mënyrë që mbron interesat private dhe jo publike. E drejta për qasje në informacionin publik e dhënë me legjislacion nuk po zbatohet plotësisht në praktikë. Informacioni i klasifikuar nga institucionet publike dhe i fshehur nga publiku mbetet një problem, pasi kjo në mënyrë efektive kufizon shoqërinë

1 Freedom House Vende dhe Territore, Strategjia dhe Raportet e Komisionit Evropian

2 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor për 2022

3 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor për 2022

civile dhe qasjen e publikut në vendime të rëndësishme. Gjithashtu mungojnë mekanizmat efektivë institucionalë për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve apo për të sanksionuar shkeljet.

Përmbledhje e të drejtës për informim

Ligjet për të drejtën për informim në Ballkanin Perëndimor janë të shkruara shumë mirë, po shumë ekspertë shprehen se ato duhet të përditësohen dhe/ose ndryshohen, pasi zbatimi i kuadrit legjislativ mbetet një problem kryesor. Kur bëhet fjalë për zbatimin e duhur të ligjeve dhe dhënien e aksesit në të dhënat publike, veçanërisht gazetarëve, institucionet publike preferojnë të mos përgjigjen, ose të përgjigjen pjesërisht, duke mos dhënë gjithmonë akses të plotë në informacionin e kërkuar. Në përgjithësi, mungesa e vullnetit politik për të zbatuar plotësisht ligjet për të Drejtën për Informim (DI) nënkupton se ato interpretohen nga zyrtarët në institucionet publike në mënyra të ndryshme.

Për BIRN duket se viti 2022 ishte shumë më i keq se viti 2021 dhe 2020 për sa i përket sigurimit të informacioneve me interes publik. Institucionet publike në rajon nuk iu përgjigjën kërkesave për DI më shpesh sesa iu përgjigjën atyre me përpikëri, ose nuk ofruan plotësisht të dhënat publike që u kërkuan.

E drejta për informim dhe e drejta për akses në dokumente publike mbrohet nga kushtetutat dhe ligjet e të gjitha shoqërive demokratike, duke përfshirë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Të gjashta vendet garantojnë të drejtën e publikut për akses në dokumentet zyrtare. Megjithatë, BIRN zbuloi se në praktikë zbatimi i kuadrit legjislativ mbetet një problem i madh.

Edhe pse gjatë vitit **2022** shumë autoritete publike iu përgjigjën plotësisht kërkesave të dorëzuara për **DI** nga gazetarët e BIRN në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi, disa nuk siguruan

gasje të plotë në dokumentet e kërkuara, as nuk ofruan ndonjë arsyetim për vendimin e tyre. Më shumë se gjysma e kërkesave nuk morën asgjë përgjigje. Vetëm **36%** e kërkesave të BIRN për DI kanë marrë **PËRGJIGJE TË PLOTË**. Disa morën **PËRGJIGJE TË PJESSHME** (4%), disa u **REFUZUAN** (3%), dhe 57% **NUK MORËN PËRGJIGJE**, edhe pas disa kërkesave të vazhdueshme nga gazetarët e BIRN.

Numri i kërkesave të PARAQITURA	376
Numri i kërkesave të MIRATUARA	134
Numri i kërkesave të MIRATUARA PJESËRISHT	15
Numri i kërkesave të REFUZUARA	14
Numri i kërkesave PA PËRGJIGJE	213

Kërkesat për DI të BIRN gjatë vitit 2022

Nga janari deri në dhjetor të vitit 2022, gazetarët e BIRN dorëzuan 376 kërkesa për DI në gjashtë vendet e Ballkanit. Informacioni i marrë nëpërmjet kërkesave u përdor për të realizuar shkrime të thelluara të publikuara në faqen kryesore të internetit të BIRN, Balkan Insight. Bazuar në reagimin e institucioneve përkatëse, BIRN që në gjendje të maste nivelin e tyre të transparencës dhe pajtueshmërinë me ligjet për të drejtë informimi.

Për të kuptuar më mirë rrethanat sfiduese të aksesit në dokumente publike në Ballkanin Perëndimor, në vitin 2022, BIRN, ndër të tjera, analizoi edhe punën e zyrave rajonale të Komisionerëve ose Avokatëve të Popullit, si dhe punën e tyre në kuadër të nismës së Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Bazuar në përvojën e BIRN dhe pas monitorimit nga afër të institucioneve publike dhe nivelit të tyre të transparencës dhe llogaridhënies, ishin **tre** institucione me të cilat BIRN mundi të bashkëpunonte pa probleme, dhe **tre** institucione me të cilat BIRN hasi probleme.

Përveç reagimit të tyre kur gazetarët e BIRN bënë kërkesa për DI në vitin 2022,

është marrë në konsideratë edhe koha që u është dashur institucioneve për të shqyrtuar ose për t'iu përgjigjur kërkesave, përgjigjet e dhëna dhe koha që gazetarët e BIRN shpenzuan për ndjekjen e kërkesave për të pasur qasje të plotë:

1.	Parlamenti i Shqipërisë
2.	Ministria e Punëve të Jashtme, Mali i Zi
3.	Qeveria e Kosovës

Institucionet me të cilat BIRN pari bashkëpunim pa probleme në 2022

1.	Qeveria e Shqipërisë
2.	Ministria e Mbrojtjes, Mali i Zi
3.	Administrata Doganore, Maqedoni e Veriut

Institucionet me të cilat BIRN pati bashkëpunim me probleme në 2022

Tre institucionet e para ishin shumë bashkëpunuese, iu përgjigjën në kohë kërkesave për të drejtë informimi dhe siguruan të gjitha dokumentet e kërkuara, si procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të dhënat për pasuritë e ngrira të qytetarëve, rekrutimet për poste të larta, dosje ligjore apo dokumente gjyqësore, fatura shpenzimesh, gjobat e vëna dhe kontratat e nënshkruara tenderëve ose shërbimeve.

Të tre institucionet në tabelën e dytë nuk iu përgjigjën mirë kërkesave për të drejtë informimi të BIRN. Ata refuzuan kërkesat për të drejtë informimi edhe kur çështjet në fjalë ishin qartazi në interes të publikut. Këto çështje ishin një vendim i qeverisë së Shqipërisë për demarkacionin detar me Greqinë, ndihma ushtarake malazeze për Ukrainën dhe sasia totale e kanabisit të importuar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021. Edhe pse dokumentet e kërkuara ishin të një rëndësie të lartë publike, asnjë prej tyre nuk u ofrua i plotë dhe disa ishin shënuar gjithashtu “të klasifikuara” pa ndonjë arsyetim të duhur ligjor për klasifikimin.

Analiza e Kërkesave të

Paraqitura

Në vitin 2022, gazetarët e BIRN dërguan kërkesa në institucione të ndryshme në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi për akses në të dhënat publike. Lista e mëposhtme rendit 20 institucionet sipas nivelit të bashkëpunimit dhe performancës së tyre.

Përgjegjshmëria e tyre vlerësohet në bazë të llojit të përgjigjeve të marra - për shembull, përgjigje të plota, të pjesshme (vetëm detaje teknike), pa përgjigje ose refuzim.

PËRGJIGJET:		
1	Parlamenti i Shqipërisë	E plotë
2	Qeveria e Bosnjës dhe Hercegovinës	E plotë
3	Qeveria e Kosovës	E plotë
4	Ministria e Punëve të Jashtme, Mali i Zi	E plotë
5	Ministria Federale e Bujqësisë, Bosnjë dhe Hercegovinë	E pjesshme
6	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Kosovë	E pjesshme
7	Ministria e Punës, Serbi	E pjesshme
8	Ministria e Punëve të Brendshme, Serbi	E pjesshme
9	Ministria e Tregtisë, Serbi	Pa përgjigje
10	Asambleja e Kosovës	Pa përgjigje

11	Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës	Pa përgjigje
12	Ministria e Financës, Mali i Zi	Pa përgjigje
13	Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë, Maqedoni e Veriut	Pa përgjigje
14	Qeveria e Serbisë	Pa përgjigje
15	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Kosovë	Pa përgjigje
16	Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Shqipëri	Pa përgjigje
17	Ministria e Shëndetësisë, Maqedoni e Veriut	Pa përgjigje
18	Qeveria e Shqipërisë	Refuzuar
19	Administrata Doganore, Maqedoni e Veriut	Refuzuar
20	Ministry of Defence, Montenegro	Refuzuar

Reagimi institucional ndaj kërkesave DI të dërguara nga gazetarët e BIRN në 2022

Tabela e mësipërme rendit institucionet sipas performancës së tyre kur u kërkohet të publikojnë dokumente publike, kohën që u është dashur për t'u përgjigjur (në përputhje me afatin ligjor) dhe nëse kanë dhënë të gjitha dokumentet e kërkuara apo jo. U shënua një bashkëpunim i shkëlqyer me Parlamentin e Shqipërisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme në Mal të Zi dhe Qeverinë e Kosovës.

Të gjitha kërkesat e gazetarëve të BIRN të paraqitura në parlamentin në Shqipëri u përgjigjën brenda afatit ligjor dhe informacioni i kërkuar u dha i plotë (procesverbale të mbledhjes së komisionit hetimor parlamentar për impiantet e trajtimit të mbetjeve urbane dhe blerja e kompanive private).

Institucioni i renditur i dyti është Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës. Një kërkesë për të drejtë informimi që iu dërgua gjykatës së Bosnjës dhe

Hercegovinës nga gazetarët e BIRN mori përgjigje brenda afatit ligjor dhe informacioni i kërkuar u zbulua plotësisht (një kopje e video/incizimeve të një gjyqi). Megjithatë, Gjykata Komunale e Sarajevës refuzoi kërkesën për të drejtë informimi (për vendime) dhe nuk dha ndonjë arsyetim ligjor për vendimin e saj. Një gazetar i BIRN i drejtoi një ankesë kryetarit të gjykatës, por nuk mori përgjigje.

Qeveria e Kosovës është renditur e treta pasi ofroi gjithashtu të plota dokumentet e kërkuara, të cilat përfshinin kopje të jetëshkrimeve të kandidatëve për anëtarë dhe drejtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, si dhe vlerësimet e kandidatëve për anëtarë dhe drejtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Ministria e Punëve të Jashtme në Mal të Zi renditet gjithashtu ndër institucionet më bashkëpunuese për kërkesat për të drejtë informimi. Kjo përbën një ndryshim, sepse në vitet e kaluara ajo nuk iu përgjigj asnjë kërkesë për të drejtë informimi nga BIRN. Në vitin 2022, ajo dha të dhëna të plota për pronat e sekuestruara të qytetarëve rusë në Mal të Zi (në përputhje me sanksionet e BE-së ndaj Rusisë), si dhe raporte ministrore për zbatimin e sanksioneve të BE-së. Përgjigja e saj u dorëzua brenda afatit ligjor përmes komunikimit elektronik.

Kategoria e dytë (E pjesshme) rendit institucionet që iu përgjigjën pjesërisht kërkesave për të drejtë informimi të BIRN. Shpesh, këto institucione ofronin vetëm detaje teknike – ose jepnin një kopje të një dokumenti që nuk ishte kërkuar, por në një farë mënyre mbulonte temën/fushën ose problemin e përmendur, edhe pse jo domosdoshmërisht korrespondonte me kornizën kohore/datat e interesit të specifikuar.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Kosovë dha vetëm detaje të pjesshme nga listat e kërkuara të pagave bruto të punëtorëve që marrin paga nga buxheti i shtetit. Ajo publikoi vetëm detaje që tashmë ishin publikuar (në faqen e saj të internetit) dhe që nuk ishin kërkuar apo përmendur në kërkesën për të

drejtë informimi.

Në mënyrë të ngjashme, në Serbi, Ministria e Punës, kur iu kërkuan të dhëna, raporte dhe dokumente vlerësimi mbi numrin e parregullsive të zbuluara nga inspektorët në kantierin e ndërtimit të projektit Belgrade Waterfront, dha vetëm detaje të pjesshme. Këto dokumente të pjesshme u siguruan më shumë se dy muaj pas marrjes së kërkesës dhe pas shumë rikujtimeve pasuese nga ana e BIRN.

Ministria e Brendshme e Serbisë renditet në të njëjtën kategori. Nga tre kërkesa për të drejtë informimi nga BIRN, ajo iu përgjigj plotësisht vetëm njëherë. Kur iu kërkua informacion për një kriminel luftime të arratisur, ministria u përgjigj, por vetëm pas një vonese. Megjithatë, kur po kësaj ministrie iu dërgua e njëjta kërkesë në vitin 2020, ajo e refuzoi kërkesën. Por pasi BIRN iu ankua Komisionerit për të Drejtën e Informimit të Serbisë, i cili urdhëroi Ministrinë e Brendshme të publikonte dokumentet, ministria iu përgjigj pozitivisht duke iu përgjigjur urdhrorit dhe i dha BIRN-it informacionin e plotë. Megjithatë, ministria renditet në kategorinë e pjesshme sepse iu përgjigj vetëm pjesërisht dy kërkesave të tjera nga BIRN në lidhje me kontrabandistët e dyshuar në vend (njërës prej kërkesave ajo iu përgjigj se çështja ishte nën hetim dhe nuk mund të jepej asnjë informacion, dhe për tjetrën dha vetëm një raport policor (të nënshkruar) që nuk u kërkua kurrë).

Kategoria e tretë (Pa përgjigje) përfshin institucionet që kanë shpërfillur kërkesat për të drejtë informimi dhe nuk janë përgjigjur fare. Në vitin 2021 kishte shumë institucione në rajon që nuk iu përgjigjën kërkesave të tilla të gazetarëve të BIRN. Megjithatë, gjatë vitit 2022 numri i institucioneve që nuk u përgjigjën u trefishua dhe më shumë se gjysma e kërkesave të BIRN për të drejtë informimi përfunduan pa përgjigje (57%).

Ministria e Tregtisë në Serbi, Kuvendi i Kosovës dhe Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës nuk iu përgjigjën kërkesave për të drejtë informimi (për eksportet e armëve të Serbisë në Ukrainë dhe SHBA, shpenzimet e

karburantit të deputetëve në Kosovë dhe detajet e sulmeve kibernetike ndaj parlamenti boshnjak).

Ministritë e Financave të Malit të Zi, Kosovës dhe Shqipërisë gjithashtu nuk iu përgjigjën kërkesave për të drejtë informimi (Raporti Vjetor i Performancës së Koncesioneve/Partneritetit Publik Privat për vitin 2021 në Shqipëri, listat e pagave bruto të punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës dhe raportet mbi zbatimin të sanksioneve të BE-së në Mal të Zi). Në këtë kategori përfshihen edhe qeveria e Serbisë dhe Qyteti i Beogradit (dokumentacioni i projektit të Urës Sava).

Gjithashtu në vitin 2022, kërkesat e gazetarëve të BIRN në Ministrinë e Shëndetësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Ministrinë e Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Kosovë për detaje rreth disa rregulloreve, statistikave, tenderave për vaksina dhe paketave të rimëkëmbjes ekonomike për COVID-19, nuk morën përgjigje edhe pse tema ishte e një rëndësie të lartë publike. Vetëm Instituti i Shëndetit Publik i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës zbuloi plotësisht statistikën e vaksinës kundër COVID-19. Ndërkohë, Instituti Publik i Republikës Srpska iu përgjigj vetëm pjesërisht të njëjtës kërkesë duke lëshuar vetëm disa lista ose raporte në lidhje me vaksinimet, të cilat nuk ishin përfshirë në kërkesën origjinale.

Në **kategorinë e fundit** janë qeveria e Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes në Mal të Zi dhe Administrata Doganore në Maqedoninë e Veriut. Disa thjesht i refuzuan kërkesat pa dhënë asnjë arsyetim, ndërsa të tjerë, si Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi, thanë se të dhënat ishin konfidenciale.

Qeverisë së Shqipërisë iu kërkuar të jepte informacione për një vendim për demarkacionin detar midis Shqipërisë dhe Greqisë. Në Mal të Zi, Ministrisë së Mbrojtjes iu kërkuar detaje teknike për ndihmën ushtarake për Ukrainën. Në Maqedoninë e Veriut, nga Administrata Doganore u kërkuar të ofronte të dhëna për sasinë totale të kanabisit të importuar në vend gjatë vitit 2021. Të gjitha rastet ishin me interes publik dhe kishin për qëllim informimin e publikut për

aktivitetet e qeverisë.

Qeveria shqiptare, kur iu kërkua të publikonte vendimin për kufijtë detarë të vendit me Greqinë fqinje, thjesht e hodhi poshtë kërkesën duke thënë se ishte e klasifikuar, pa ndonjë arsytim të duhur ligjor se cilat pjesë të vendimit duhet të mbeten të klasifikuara. BIRN e raportoi gjithashtu rastin në zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri, me argumentin se qeveria nuk dha asnjë justifikim ligjor për vendimin e saj dhe se çështja ishte e një rëndësie të lartë publike. Zyra e Komisionerit nuk iu përgjigj kërkesës së BIRN për t'i kërkuar qeverisë të jepte arsyetimin e duhur për refuzimin.

Ministria e Mbrojtjes në Mal të Zi nuk publikoi asnjë nga dokumentet e kërkuara. Ajo thjesht e hodhi poshtë kërkesën për detaje teknike në lidhje me ndihmën ushtarake të Malit të Zi për Ukrainën që nga fillimi i vitit 2022. Ministria thjesht tha se të dhënat e kërkuara ishin konfidenciale, pa ndonjë arsytim të duhur.

Administrata Doganore në Maqedoninë e Veriut nuk e mori në konsideratë kërkesën e BIRN për të drejtë informimi për informacion për sasinë totale të kanabisit të importuar në vend në vitin 2021 si informacion me interes publik. Ajo e refuzoi kërkesën pa arsyetimin e duhur ligjor dhe pa thënë se cila pjesë e kërkesës i referohej informacionit të klasifikuar dhe pse. Arsyetimi i saj për refuzimin nuk ishte në përputhje me ligjet dhe procedurat për të drejtë informimi në vend.

SHQIPËRIA

Në Shqipëri, ligji për DI mund të jetë më i vjetri në rajon dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vend mbetet më aktiv në monitorimin dhe kritikimin e autoriteteve, por institucionet publike ende nuk janë transparente.

Vitin e kaluar në Shqipëri, BIRN paraqiti **34** kërkesa për DI dhe vetëm **58%** morën përgjigje të plotë. **Gjashtë për qind** u refuzuan dhe **15%** morën përgjigje të pjesshme (institucioni iu përgjigj kërkesës, por nuk dha domosdoshmërisht asnjë nga të dhënat/dokumentet e kërkuara). Pjesa e mbetur prej **21%** nuk iu përgjigj fare (institucionet i shpërfillën kërkesat për DI).

Institucioni me vlerësimin më të keq ishte qeveria shqiptare. Kur iu kërkua të bënte publik një vendim për lidhjen e një kontrate mes qeverisë dhe një kompanie konsulente për hartimin e një marrëveshjeje që do të lidhej midis Shqipërisë dhe Greqisë, duke iu referuar përcaktimit të zonave detare në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ajo e hodhi poshtë kërkesën, duke thënë se ishte informacion **i klasifikuar**. E njëjta kërkesë, për zonat detare mes Shqipërisë dhe Greqisë fqinje, iu drejtua edhe Ministrisë së Jashtme. Ministria tha gjithashtu se materiali i kërkuar ishte informacion i klasifikuar.

Kur BIRN pyeti qeverinë e Shqipërisë për bazën ligjore dhe arsyet e klasifikimit të dokumentit, ajo nuk u përgjigj kurrë. Çështja iu drejtua edhe Zyrës së Komisionerit në Shqipëri, me argumentin se dokumentet ishin me interes publik dhe autoritetet nuk dhanë asnjë arsye ligjore për vendimin e tyre. Komisioneri gjithashtu nuk u përgjigj.

Tabela e mëposhtme tregon institucionet të cilave gazetarët e BIRN iu drejtuan me kërkesa për DI, dokumentet e kërkuara, numrin e kërkesave dhe nëse u morën apo jo përgjigje:

DOKUMENTI I KËRKUAR:		PËRGJIGJA:	
1	Parlamenti i Shqipërisë	Procesverbale të mbledhjeve të Komisionit Hetimor Parlamentar	Përgjigje e plotë
2	Ministria e Kulturës	Vendim i Këshillit të Ministrave	Përgjigje e plotë

3	Policia e Shtetit	Lista të sulmeve shpërthyese në pesë vitet e fundit; Kultivimi i kanabisit në ambiente të mbyllura/ procedurat e ndjekura për rastet e ekstradimit	Përgjigje e pjesshme/ Pa përgjigje
4	Qeveria e Shqipërisë	Vendim për zonat detare midis Shqipërisë dhe Greqisë	Refuzuar
5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Inventari i dokumenteve për pasuri të paluajtshme dhe investime strategjike	Pa përgjigje
6	Ministria e Brendshme	Listat e dronëve nga Turqia dhe prova për çdo kontratë ekzistuese; Procedurat protokollare të ndjekura për një çështje ekstradimi	Pa përgjigje

Përvoja me institucionet në Shqipëri bazuar në reagimin ndaj kërkesave për të drejtë informimi

Në Shqipëri, problemet me Ligjin për të Drejtë Informimi janë sistematike dhe nuk kanë lidhje me ligjin në vetvete, por me mungesën e sundimit të ligjit në përgjithësi. Administrata publike e vendit është shumë joprofesionale dhe e politizuar. Disa ministri nuk arrijnë të kuptojnë dallimin ndërmjet rolit të koordinatorit të caktuar për trajtimin e kërkesave për DI dhe stafit të tyre për marrëdhëniet me publikun. Shpesh, ata i trajtojnë kërkesat për DI si një çështje politike dhe përgjigja e tyre nuk varet nga baza ligjore, por nga ai që ata mendojnë se do të jetë ndikimi për shëfën e tyre në dorëzimin e dokumentit. Nga sa janë në dijeni gazetarët e BIRN, në Shqipëri asnjë koordinatori DI nuk është i trajnuar mirë ose nuk e kupton dhe respekton plotësisht ligjin për DI. Duke qenë se shumica e posteve publike janë emërimet politike, askush nuk dëshiron të zbatojë plotësisht ligjet në letër.

Procesi i trajtimit të kërkesave të refuzuara është i kushtueshëm, i pavolitshëm dhe joefikas. Komisioneri, i cili duhet të mbikëqyrë zbatimin e ligjit, shpesh e zvarrit procesin. Ndodh rrallë që për zyrtarët të vihen gjopa dhe që ato të zbatohen. Procedurat gjyqësore për raste të tilla zgjasin me vite. E drejta për informim në Shqipëri mbetet një ligj i shkruar shumë mirë në letër!

Gjergj Erebara, gazetar i BIRN, Shqipëri

Në **Bosnje dhe Hercegovinë**, BIRN paraqiti **11** kërkesa për të drejtë informimi në vitin 2022. Pavarësisht se më shumë se gjysma e kërkesave morën përgjigje, vetëm gjykatat dhe Instituti i Shëndetit Publik i Federatës dhanë përgjigje të plota. Agjencia Shtetërore për Investigim dhe Mbrojtje (SIPA) refuzoi një kërkesë (pa bazë të qartë ligjore) duke thënë se një hetim ishte ende në vazhdim dhe Asambleja Parlamentare nuk u përgjigj fare.

Pothuajse gjysma e kërkesave të parashtruara për të drejtë informimi morën përgjigje të plotë (**45%; ose 5 nga 11**); 9% morën përgjigje të pjesshme; **18%** u refuzuan, dhe pjesa tjetër **28%** u përmbushën pjesërisht.

BIRN kërkoi qasje në detaje në lidhje me numrin e vaksinave të administruara, të skaduara, të shkatërruara dhe rezervave të mbetura të vaksinave për COVID-19 në Institutin e Shëndetit Publik të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe mori përgjigje të plota. Megjithatë, e njëjta kërkesë e dorëzuar në Institutin e Shëndetit Publik të Republikës Srpska mori përgjigje të pjesshme. Në tabelën e mëposhtme renditen institucionet të cilëve iu drejtuan kërkesa për të drejtë informimi, dokumentet e kërkuara, numri i kërkesave dhe nëse u morën apo jo përgjigje:

DOKUMENTI I KËRKUAR:		PËRGJIGJA:	
1	Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës	Kopje e videos së një gjyqi	Përgjigje e plotë
2	Instituti i Shëndetit Publik i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës	Detajet (shifrat) e vaksinave të administruara, të skaduara, të shkatërruara dhe rezervave të mbetura të vaksinave kundër COVID-19)	Përgjigje e plotë
3	Asambleja Parlamentare e Bosnjës dhe Hercegovinës	Detaje të sulmeve kibernetike ndaj parlamentit	Pa përgjigje
4	Agjencia Shtetërore për Investigim dhe Mbrojtje	Detaje të sulmeve kibernetike ndaj parlamentit	Refuzuar

5	Ministria Federale e Bujqësisë	Informacion rreth prerjeve të paligjshme	Përgjigje e pjeshme
---	--------------------------------	--	---------------------

Përvoja me institucionet në Bosnjë dhe Hercegovinë bazuar në reagimin ndaj kërkesave për të drejtë informimi

Në përgjithësi, situata në Bosnjë dhe Hercegovinë mbetet sfiduese, pasi shumica e institucioneve publike nuk përgjigjen. Vetëm disa institucione të nivelit shtetëror iu përgjigjen si duhet kërkesave për të drejtë informimi të BIRN (dhe gjithashtu përmbushin afatet ligjore).

Azem Kurtic, gazetar i BIRN në Bosnje dhe Hercegovinë

Në **Kosovë** në vitin 2022, BIRN dorëzoi **254** kërkesa për të drejtë informimi për qasje në të dhëna publike. Pothuajse tre të katërtat e kërkesave nuk morën asnjë përgjigje. Krahasuar me vitin 2021, gjysma e kërkesave të paraqitura morën përgjigje të plotë dhe iu dhanë të plota dokumentet e kërkuara.

Shumica e kërkesave në vitin 2022 u shpërfillën plotësisht (**70%**). Gjithsej **28%** morën përgjigje të plotë, ndërsa **2%** e përgjigjeve përmbanin vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar. Asnjë nuk u refuzua. Dokumentet e kërkuara përfshinin procedurat rekrutimit për zyrtarët publikë të nivelit të lartë, të dhëna të kallëzimeve penale, lista të shtetasve të huaj, përfitimet financiare të zyrtarëve publikë, kontrata publike, fatura për shpenzime zyrtare dhe të dhëna për vaksinimit kundër COVID-19.

Tabela e mëposhtme liston institucionet e drejtuara, llojet e dokumenteve të kërkuara, numrin e kërkesave të paraqitura dhe përgjigjet e marra, nëse pati:

INSTITUCIONI (# i kërkesave për DI):	DOKUMENTI I KËRKUAR:	PËRGJIGJA:
1	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Procedurat e rekrutimit për zyrtarë të nivelit të lartë; listat e mësuesve vendas që nuk janë shtuar në listën e pagave mujore; një përditësim mbi paketën e rimëkëmbjes së ekonomisë; kriteret dhe përditësimet për buxhetin e ndarë për menaxhimin e krizës së COVID-19; listat e pagave bruto të punonjësve që marrin paga nga buxheti i shtetit
2	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Të dhënat e figurave politike me kallëzim penal për mosdeklarim të asetëve (pasurisë); vlerësimi i rasteve të dyshimta për korrupsion
3	Ministria e Punëve të Brendshme	Listat e shtetasve të huaj (rusë) që nuk lejohen të hyjnë në vend; automjete të importuara/ të regjistruara; të dhënat e procesit të rekrutimit
4	Asambleja e Kosovës	Përfitimet financiare të këshillave të Kuvendit; listat e anëtarëve që votojnë për kodin civil; Faturat për shpenzimet e karburantit për deputetët

5	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	Kopjet e kontratave publike; listën e kandidatëve për postin e drejtorit të Baletit Kombëtar; kontratat dhe shpenzimet për Teatrin Kombëtar të Kosovës (2017-2021); regjistrimet e thirrjeve publike për zgjedhjet e Federatës së Futbollit të Kosovë	Pa përgjigje
6	Policia e Kosovës	Vendimi për anulimin e certifikimit të punonjësve policorë; arrestimet masive gjatë një festivali; të dhëna dhe statistika për konfiskimin e lëndëve narkotike, kontrabandës dhe laboratorëve të drogës	Pa përgjigje
7	Qeveria e Kosovës	Vlerësimi i kandidatëve për anëtarë dhe kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik; plani i veprimit i qeverisë për programin e personave të zhdukur	Përgjigje e plotë
8	Zyra e Kryeministrit	Shpenzimet e kryeministrit gjatë vizitave zyrtare shtetërore (jashtë vendit); Programi dhe Plani i Programit të Gjuhës së Shenjave	Përgjigje e plotë

9	Ministria e Shëndetësisë	Dokumentet e tenderit për vaksinim; dokumentet e tenderit të prokurimit publik shëndetësor; kontratat publike/ listat e procesit të vaksinimit në pikat kufitare; numri i rasteve pozitive me variante të reja të COVID19	Përgjigje e plotë/ Pa përgjigje
10	Dogana e Kosovës	Lista e importeve në Kosovë në vitin 2022 (makina, grurë, miell, vaj)	Pa përgjigje

Përvoja me institucionet në Kosovë bazuar në reagimin ndaj kërkesave për të drejtë informimi

Vitin e kaluar, institucionet në **Mal të Zi** më në fund filluan t'u përgjigjen kërkesave të BIRN për të drejtë informimi. Gjatë vitit 2022, gazetarët e BIRN dorëzuan **katër** kërkesa për të drejtë informimi në institucionet publike në Mal të Zi.

Vetëm **një** prej kërkesave për DI mori përgjigje të plotë dhe dokumenti i kërkuar u publikua ose u zbulua (**1 nga 4**). Vetëm **një** u refuzua dhe **dy** nuk morën asnjë përgjigje.

Tabela e mëposhtme rendit institucionet në Mal të Zi sipas reagimit të tyre ndaj kërkesave për DI në vitin 2022:

INSTITUCIONI (# i kërkesave për DI):		DOKUMENTI I KËRKUAR:	PËRGJIGJA:
1	Ministria e Punëve të Jashtme	Lista e pronave të sekuestruara të qytetarëve rusë në Mal të Zi sipas kufizimeve të BE-së ndaj Rusisë	Përgjigje e plotë

2	Ministria e Punëve të Jashtme	Proceset e arbitrazhit para gjykatave ndërkombëtare	Pa përgjigje
3	Ministria e Financave	Raportet mbi zbatimin e sanksioneve të BE-së	Pa përgjigje
4	Ministria e Mbrojtjes	Detaje teknike mbi ndihmën ushtarake dhënë Ukrainës	Refuzuar

Përvoja me institucionet në Mal të Zi bazuar në reagimin ndaj kërkesave për të drejtë informimi

Pavarësisht ndryshimit të administratës në Mal të Zi gjatë dy viteve të fundit, nuk ka pasur shumë përmirësime në lidhje me aksesin në informacionin publik. Edhe qeveria nuk ka një politikë uniforme për kërkesat për të drejtë informimi, pasi disa ministri japin informacione brenda afatit, ndërsa disa të tjera i shpërfillin kërkesat. Sipas përvojës sime, institucionet shtetërore zakonisht e keqpërdorin ligjin dhe nuk u përgjigjen kërkesave për DI.

Gjatë vitit të kaluar, Ministria e Financave i shpërfilli dy herë kërkesat për DI të BIRN dhe nuk u përgjigj fare (nëse ato u refuzuan apo jo). Mbi të gjitha, Ministria e Mbrojtjes, pasi iu kërkua të jepte detaje të donacioneve ushtarake malazeze për Ukrainën, pretendoi se të dhënat janë konfidenciale, por pas emërimit të ministrit të ri të mbrojtjes, të njëjtat të dhëna iu dhanë edhe mediave të tjera. Shkurtimisht, autoritetet e reja janë më të hapura ndaj kërkesave për DI, por ende nuk po bashkëpunojnë siç pritej me mediat dhe OJQ-të.

Samir Kajosevic, gazetar i BIRN në Mal të Zi

Në **Maqedoninë e Veriut** vitin e kaluar, BIRN dorëzoi **58** kërkesa në agjenci të ndryshme shtetërore, zyra, gjykata, autoritete doganore dhe ministri.

Shumica e kërkesave për DI të dorëzuara morën përgjigje të plotë **(55%)**; **15%** u refuzuan dhe pjesa tjetër e mbetur nuk morën asnjë përgjigje **(30%)**. Kërkesat e refuzuara kishin të bënin me importet e kanabisit në vend. Si Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave ashtu edhe Administrata Doganore nuk dhanë ndonjë arsyetim ligjor për moszbulimin e informacionit.

Tabela e mëposhtme liston institucionet e drejtuara, llojet e dokumenteve të kërkuara, numrin e kërkesave të paraqitura dhe përgjigjet e marra:

INSTITUCIONI (# i kërkesave për DI):		DOKUMENTI I KËRKUAR:	PËRGJIGJA:
1	Gjykatat	Vendime, vendime përfundimtare për caktimin e masave, kopje të marrëveshjeve publike	Përgjigje e plotë
2	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit	Inspektime të dokumenteve të pronësisë	Përgjigje e plotë
3	Zyra e Mbrojtësit Publik	Të dhënat për numrin e përgjithshëm të çështjeve (tre vitet e fundit) që u tërhoqën për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit; kopje të kontratave / Kopje të faturave për shërbime të kontraktuara	Përgjigje e plotë / Refuzuar

4	Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë	Raportet e mediave të shkruara për përdorimin e fondeve të marra për vitin 2020; raporti vjetor për masat disiplinore dhe përgjegjësitë financiare të zyrtarëve administrativë për vitin 2021	Pa përgjigje/ Përgjigje e plotë
5	Agjencia për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar	Raporte vjetore	Pa përgjigje
6	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave / Administrata Doganore	Sasia totale e kanabisit të importuar në Maqedoninë e Veriut në vitin 202	Refuzuar
7	Partia politike (VMRO-DPMNE)	Fatura për taksën e paguar të pronës nga viti 2016-2021	Refuzuar

Përvoja me institucionet në Maqedoninë e Veriut bazuar në reagimin ndaj kërkesave për të drejtë informimi

Në **Serbi** në vitin 2022, BIRN dorëzoi **15** kërkesa për të drejtë informimi në institucione të ndryshme, duke përfshirë qeverinë, ministri të ndryshme, Institutin e Transportit dhe agjencitë publike lokale.

Vetëm **33%** e kërkesave të parashtruara për DI morën përgjigje. përgjigjur. Prej tyre, vetëm **13%** morën përgjigje të plotë dhe pjesa tjetër **20%** morën përgjigje të pjesshme. Asnjë nuk u refuzua. Gjithsej **67%** nuk morën asnjë përgjigje.

Situata në Serbi për sa i përket kërkesave për DI ishte më e keqe se në vitet e kaluara. Më shumë institucione nuk iu përgjigjen kërkesave për DI, dhe vetëm shumë pak kanë vepruar bazuar në vendimet e Komisionerit për Informacionin me Rëndësi Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për publikimin e

dokumenteve të kërkuara (përfshirë disa që publikuan informacion të pjesshëm).

Në vitin 2022, Ministria e Tregtisë ishte institucioni publik më problematik kur vinte puna te vënia në dispozicion e dokumenteve publike. Të tre kërkesat që ajo mori nga BIRN në vitin 2022 (për eksportet e armëve) u shpërfillën.

Kur Ministrisë së Brendshme iu kërkuar dokumentacioni për kontrabandistët, ajo u përgjigj vetëm pjesërisht. Fillimisht ajo tha për BIRN se për shkak të një hetimi në vazhdim nuk mund të jepte asnjë informacion për rastin. Pas kërkesës së dytë të BIRN, ajo dërgoi një raport policor të nënshkruar, i cili nuk ishte kërkuar apo nuk përmendej kurrë në kërkesë.

Megjithatë, pati një përmirësim të lehtë në mënyrën se si Ministria e Brendshme e Serbisë trajtoi kërkesat për të arratisurit. Në vitin 2020, ministria i refuzoi kërkesat e BIRN për vendndodhjen e një kriminelit të dënuar lufte dhe u përgjigj vetëm pasi Komisioneri për të Drejtën e Informimit i Serbisë i tha ta bënte këtë, por në vitin 2022 ajo iu përgjigj një kërkesë për të njëjtin rast, megjithëse me një vonesë të vogël.

Ndërsa publiku, veçanërisht banorët e Beogradit, ishin të etur për të mësuar më shumë rreth projektit të urës së re të Savës, qeveria dhe qyteti i Beogradit nuk iu përgjigjën kërkesave për DI për dokumentacion në lidhje me të. Instituti i Transportit dhe Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës iu përgjigjën pjesërisht kërkesave, por përgjigjet e tyre nuk përmbanin asnjë pjesë të dokumentacionit të kërkuar. Instituti dha një përgjigje të shkurtër, duke thënë se Ligji për Informimin Publik nuk vlen për të dhe kështu nuk kërkohet që t'i japë BIRN asnjë informacion. Megjithatë, ai sugjeroi që e njëjta kërkesë t'i referohej qytetit të Beogradit.

Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës tha se personi që menaxhonte kërkesat për DI kishte rezultuar pozitiv me COVID-19 dhe deri në kthimin e tij asnjë tjetër nuk mund të përgjigjej. BIRN i drejtoi të njëjtën kërkesë

direkt zyrës së ministrit, por përpjekjet e shumta për të kontaktuar me emailin zyrtar të DI dhe zyrën e ministrit nuk patën asnjë përgjigje. Megjithatë, pas disa kohësh, BIRN mori përgjigje nga zyrtari i të drejtës për informim, i cili tha se ata janë në pritje të miratimit nga Kabineti i Ministrave dhe nuk mund të jepnin asnjë informacion pa marrë përgjigje nga një nivel më i lartë. Pas një ankese në zyrën e Komisionerit dhe gati dy muaj pas dorëzimit të kërkesës fillestare, BIRN mori dokumentacionin e plotë nga Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës.

Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Punës u përgjigj vetëm pjesërisht, thjesht duke dhënë një përgjigje që nuk përmbante asnjë pjesë të dokumentacionit të kërkuar (parregullsi të zbuluara nga inspektorët e punës në kantierin e projektit të Belgrade Waterfront, dhe e dërgoi përgjigjen e saj vetëm disa muaj pas marrjes së kërkesës së BIRN).

Tabela e mëposhtme rendit institucionet e adresuara, numrin e kërkesave të paraqitura, dokumentet e kërkuara dhe përgjigjet zyrtare të marra:

INSTITUCIONI (# i kërkesave për DI):		DOKUMENTI I KËRKUAR:	PËRGJIGJA:
1	Ministria e Brendshme	Numri kontrabandistëve të arrestuar në Serbi	Përgjigje e pjesshme
2	Ministria e Tregtisë	Eksportet serbe të armëve në Ukrainë në vitin 2022; eksportet e armëve në Shtetet e Bashkuara dhe eksportet e armëve për kompaninë private Beatronics Supply	Pa përgjigje
3	Zyra e Qeverisë për IT	Mbrojtja e të dhënave personale dhe mekanizmi për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve	Pa përgjigje

4	Qyteti i Beogradit	Dokumente për projektin Ura Sava.	Pa përgjigje
5	Qeveria e Serbisë	Dokumente për projektin Ura Sava.	Pa përgjigje
6	Instituti i Transportit	Dokumente për projektin Ura Sava.	Përgjigje e pjeshme
7	Ministria e Ndërtimit, Transportit dhe Infrastrukturës	Dokumente për projektin Ura Sava.	Përgjigje e pjeshme
8	Ministria e Punës	Raportet dhe parregullsitë e zbuluara nga inspektorët e punës në kantierin e ndërtimit të Belgrade Waterfront, përfshirë Kullën e Beogradit	Përgjigje e pjeshme
9	Ministria e Minierave dhe Energjetikës	Një listë e kompanive që u janë dhënë leje për kërkim litiumi	Përgjigje e plotë
10	Ministria e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes	Mbrojtja e të dhënave personale dhe mekanizmat për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve	Përgjigje e plotë

Përvoja me institucionet në Serbi bazuar në reagimin ndaj
kërkesave për të drejtë informimi

Asgjë nuk ndryshoi shumë në vitin 2022. Por kur i krahasojmë tre vitet e fundit, më duhet të them se viti 2021 dhe 2022 ishin padyshim shumë më të mira se 2020. Në vitin 2020 në Serbi kishim gjendje të jashtëzakonshme, disa nga institucionet nuk funksiononin dhe ato që funksionin përdorën COVID-19 si justifikim. Gjithashtu, në vitin 2020, shumica dërrmuese e kërkesave tona për DI kishin të bënin me COVID-19 dhe kjo temë ishte goxha jo transparente pasi institucionet fshihnin gjërat nga publiku.

Sfida më e madhe me të cilën jam përballur çdo ditë në këto tre vite është fakti që institucionet tona kanë këtë politikë mostransparence. Për shembull, nëse jam duke punuar me një artikull për vepra të caktuara penale, mund të marr informacione të dobishme vetëm nëse ajo çështje specifike ka arritur në gjykatë. Nëse nuk është kështu, nëse prokuroria është ende duke e hetuar, atëherë nuk do të marr asgjë prej tyre. Natyrisht, ka gjëra që nuk mund të mí japin, pasi që mund të rrezikojnë hetimin e tyre; por ka gjithmonë pjesë që mund t'i zbulojnë për publikun – po të donin. Ka edhe disa raste që kanë qenë nën hetim gjatë 20 viteve të fundit dhe kur u kërkon informacione, ata thonë se hetimi është në vazhdim". Unë mendoj se ata e përdorin këtë si një justifikim kur nuk duan të zbulojnë asnjë informacion.

Milica Stojanovic, gazetare e BIRN në Serbi

Komisionerët për të drejtën e informimit dhe Avokatët e Popullit

Në Ballkanin Perëndimor, ligjet për të Drejtën e Informimit monitorohen dhe mbikëqyren nga institucione të krijuara posaçërisht, si dhe nga organizatat vendase dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile që monitorojnë në mënyrë të pavarur çështjet e të drejtës për informim dhe matin llogaridhënien institucionale.

Sipas Ligjeve për të Drejtën për Informim, zyrat e Komisionerëve për të Drejtën e Informimit dhe të Avokatit të Popullit krijohen si entitete të pavarura për të monitoruar nga afër zbatimin e legjislacionit, për të reaguar ndaj shkeljeve, për të ngritur akuza ligjore për shkeljet dhe, më e rëndësishmja, për t'i mbajtur institucionet publike përgjegjëse nëse nuk i kanë të dhënat aktuale të disponueshme publikisht në internet në faqet e tyre të internetit.

Për të kuptuar më mirë sfidat në vitin 2022, BIRN zhvilloi intervista online me Komisionerët dhe përfaqësuesit e zyrave të tyre në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe me Avokatin e Popullit në Bosnje dhe Hercegovinë. Zyrtarët përkatës në Mal të Zi dhe Serbi nuk iu përgjigjën kërkesave tona për intervistë, pavarësisht disa telefonatave dhe bashkëpunimit të mirë të mëparshëm lidhur me kërkesat për DI.

Në përgjithësi, Komisionerët vazhdojnë të përballen me ankesa nga gazetarët

për mungesën e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe për etiketimin e gabuar të dokumenteve si “të klasifikuara”. Shumë institucione përpiqen të ekzekutojnë vendime ose rekomandime nga zyrat e Komisionerëve, por jo gjithmonë e bëjnë këtë plotësisht. Në disa raste, edhe pas vendimit të një Komisioneri për publikimin e plotë të dokumenteve të kërkuara nga BIRN, institucionet publike ofruan vetëm dokumentacion të pjesshëm (këta përfshinin Ministrinë e Brendshme në Serbi dhe Ministrinë për Sistem Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive në Maqedoninë e Veriut). Vetëm në Shqipëri institucionet siguruan plotësisht dokumentet e kërkuara pas ndërhyrjes së Komisionerit (Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Rajonale e Mjedisit).

Ashtu si në vitin 2020 dhe 2021, zyrat e Komisionerëve vazhduan të operojnë me kapacitete dhe burime shumë të kufizuara (financiare, njerëzore dhe teknologjike) dhe shpesh iu desh më shumë kohë për të monitoruar dhe mbrojtur në mënyrë efektive ligjin e të drejtës për informim. Për shembull, në Shqipëri, Komisioneri vuri në dukje se të gjitha institucionet publike kanë emëruar Koordinatorët e tyre për DI, por nuk kishin kapacitetet për t'i trajnuar të gjithë. Në Kosovë, Komisioneri i sapoemëruar tha se stafi i tyre shumë i vogël shpesh ka punuar pas orarit të punës për të siguruar që përgjigjet të përpunohen shpejt dhe që institucionet publike të mbahen përgjegjëse. Megjithatë, në Maqedoninë e Veriut, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione Publike është ende në pritje të një programi softuer (i financuar nga një donacion projekti) që të instalohet dhe të vihet në zbatim. Bosnja dhe Hercegovina nuk ka një Komisioner dhe në vend të kësaj Avokati i Popullit është kujdestari i DI-së, duke operuar me burime shumë të kufizuara.

SHQIPËRIA

Në vitin 2022, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri vazhdoi monitorimin e autoriteteve sipas programeve të saj të transparencës (administrata shtetërore dhe vendore)

duke forcuar rolin e koordinatorit të së drejtës për informim, duke përditësuar regjistrat e saj me kërkesa dhe përgjigje, duke shqyrtuar ankesat, duke kryer hetime administrative, duke mbajtur seanca dëgjimore dhe duke marrë rekomandime dhe vendime, mes aktiviteteve të tjera.

Megjithatë, në raportin e saj vjetor për vitin 2021, Zyra e Komisionerit deklaroi se “ka ende shumë rrugë për të bërë për të arritur standardet e kërkuara për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese dhe se nëpunësit publikë duhet të përmirësojnë performancën e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore”.⁴

Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë vuri në dukje se “ligji për të drejtën për informim parashikon përgjegjësinë administrative të zyrtarëve publikë që nuk përmbushin detyrimet e tij, të sanksionuara me gjoba dhe mundësinë që Komisioneri të marrë masa disiplinore ndaj personit përgjegjës”.⁵

Në vitin 2021, Zyra e Komisionerit mori 992 ankesa për autoritetet publike mbi “qasjen në informacion ose zbulimin e dokumenteve zyrtare”. Një total prej 44 ankesash u mbartën nga viti 2020 dhe kështu gjatë vitit 2021 ishin në shqyrtim gjithsej 1,036 ankesa.

Por për vitin 2022, Zyra e Komisionerit po punonte për statistikën e vitit kur u përpilua ky raport.

Shumë institucione publike kanë miratuar një program transparence që është krijuar nga zyra e Komisionerit të vendit të tyre dhe e kanë publikuar programin në faqen e tyre të internetit. Në vitin 2020, 239 autoritete publike publikuan programet e tyre të transparencës. Në vitin 2021, nga 374 institucione publike që u monitoruan, 300 autoritete kishin publikuar programin e tyre të transparencës. Në vitin 2022, 374 nga 374 autoritete kishin emëruar koordinatore për t'u marrë me kërkesat për të drejtën për informim.

4 Komisioneri në Shqipëri Raporti 2021

5 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2022

Sipas programeve të transparencës, Zyra e Komisionerit monitoron vazhdimisht progresin e çdo autoriteti publik për t'u siguruar që informacioni i publikuar në faqet e internetit të autoriteteve publike plotëson kriteret e përcaktuara dhe është i përshtatshëm dhe i përditësuar.

Zyra e Komisionerit tha për BIRN se nga të gjitha ankesat e depozituara gjatë vitit 2021, 49 u çuan për shqyrtim në vitin 2022.

Bazuar në monitorimin e vitit të kaluar, Zyra e Komisionerit lëshoi 50 rekomandime për autoritetet publike që nuk kishin ndjekur programin e transparencës. Në vitin 2022, Zyra e Komisionerit kreu 50 hetime. Synimi i tyre nuk ishte vetëm të jepnin sanksione administrative (gjoba) për zyrtarët që nuk siguronin akses të plotë, por gjithashtu të punonin drejt rritjes së ndërgjegjësimit se si ata mund të ishin më transparentë dhe më proaktivë.

Në vitin 2022 situata e monitoruar nga Zyra e Komisionerit dukej paksa e përmirësuar (më shumë programe transparence ishin të disponueshme në internet, u emëruan më shumë koordinatore dhe u publikuan regjistrat e përgjigjeve dhe kërkesave për t'u mundësuar qytetarëve dhe palëve të interesuara të kenë akses më të drejtpërdrejtë në informacionin publik. Por ka ende një shumë punë për të bërë, tha Elona Hoxhaj, drejtoresha e përgjithshme për të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit i tha BIRN se po punon për të propozuar disa ndryshime në legjislacionin aktual dhe do të vazhdojë të rrisë ndërgjegjësimin e nëpunësve publikë për rëndësinë e të drejtës për informim dhe do të vazhdojë të mbështesë autoritetet që të bëhen më transparente dhe të hapura për publikun.

Bosnja dhe Hercegovina

Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut i Bosnjës dhe Hercegovinës është një institucion i pavarur i krijuar për të promovuar qeverisjen e mirë dhe

shtetin ligjor dhe ka autoritetin për të mbrojtur zbatimin e Ligjit për Qasje në Informacion.

Ligji për qasje në informacion i detyron autoritetet publike që t'u përgjigjen kërkesave për të drejtë informimi në mënyrën dhe formën e përcaktuar në legjislacion.

Kur një individ parashton një ankesë, Avokati i Popullit e regjistron rastin dhe kryen procedurat e duhura nëse ka shkelje, dhe më pas i jep rekomandimin e duhur institucionit publik të përfshirë.

Kur Institucioni i Avokatit të Popullit kryen procedura hetimore, nga të dyja palët kërkohet që të japin deklaratat për rastin e treguar në ankesë. Vendimi që merret nga Avokati i Popullit varet nga përgjigja e dhënë, si dhe nga komentet e dhëna nga të dyja palët dhe veprimet e ndërmarra ose jo nga institucioni publik i përfshirë.

Zyra e Avokatit të Popullit do të publikojë një pasqyrë të detajuar të situatës në Raportin e saj Vjetor 2022, i cili ende nuk është finalizuar.

Në vitin 2022, Avokati i Popullit regjistroi gjithsej 308 ankesa për shkelje të së drejtës për qasje në informacion - numri më i madh i ankesave të pranuar ndonjëherë. Në vitin 2021 u pranuan gjithsej 304 ankesa, ndërsa në vitin 2020 numri i ankesave të pranuar ishte vetëm 231.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar gjatë vitit 2022, autoriteteve publike iu dhanë rekomandime në 76 raste.⁶

Avokati i Popullit i tha BIRN se kur u jep rekomandime autoriteteve publike, ai nuk ka mandatin dhe autoritetin për të ndryshuar ose revokuar çdo vendim të

6 BIRN i mori të dhënat paraprake direkt nga Institucioni i Avokatit të Popullit

marrë dhe as për të parandaluar zbatimin e tij. Ai nuk mund të udhëzojë asnjë autoritet që të ofrojë informacionin e kërkuar sipas legjislacionit për DI dhe mund të rekomandojë vetëm që kjo të bëhet.

Ankesat që mori nga janari deri në dhjetor 2022 kishin të bënin me autoritetet publike në të gjitha nivelet qeveritare në Bosnje dhe Hercegovinë. Avokati i Popullit tha se arsyet kryesore të përmendura në ankesa ishin për shkak të mos dhënies së vendimeve, mos sigurimit të mjeteve juridike, përgjigjeve joefikase nga organet inspektuese dhe mosveprimi të organeve kompetente brenda afateve ligjore kur vendosin për kërkesat e parashtresve.

Avokati i Popullit ka shprehur të njëjtat shqetësime, që nga viti 2020⁷, se edhe pse të gjitha autoritetet publike janë të detyruara të publikojnë një Udhëzues për Qasje në Informacion dhe të kenë një Indeks të Regjistrimit të Informacionit, ato nuk kanë publikuar materiale të reja në faqet e tyre të internetit për t'i vënë ato në dispozicion për publikun dhe nuk kanë përditësuar informacionin ekzistues në faqet e tyre.

Në përgjithësi, autoritetet publike në Bosnje dhe Hercegovinë nuk publikojnë rregullisht informacione që supozohet t'i bëjnë publike sipas ligjit. Ata nuk publikojnë rregullisht një indeks të regjistrimit të informacionit, përditësime të ndryshimeve të kompetencave, veprime ose rrethana të tjera që ndikojnë në listën e informacionit që duhet të publikohet rregullisht në mënyrë që të jetë në dispozicion për publikun. Shumica e autoriteteve publike nuk dorëzojnë të dhëna statistikore për kërkesat për qasje në informacion tek organet legjislative dhe Institucioni i Avokatit të Popullit siç kërkohet me ligj.

Komisioni Evropian tha në raportin e tij të progresit për vitin 2022⁸ se “gëzimi i së drejtës për qasje në informacionin publik mbetet kontradiktore, duke iu referuar dallimeve midis asaj që shkruhet në legjislacion dhe mënyrës se si ai zbatohet.

7 Raporti Vjetor 2020 i Institutit të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut i Bosnjës dhe Hercegovinës

8 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Bosnjë dhe Hercegovinë 2022

Dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjen në informacion ende interpretohen në një mënyrë që mbron interesat private dhe jo publike, kuadrit legjislativ ende i mungojnë mekanizmat efektivë institucionalë për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve ose për të sanksionuar shkeljet dhe legjislacioni duhet të përafrohet me atë ndërkombëtar dhe standardet evropiane, tha Komisioni Evropian.

KOSOVA

Në qershor 2021, Kosova më në fund emëroi Komisionerin për të Drejtën për Informim. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Aksesit në Informacion gjithashtu u bë operacionale dhe filloi të pranonte ankesa për qasjen e publikut në informacione.

Pas ratifikimit të Ligjit për Akses në Dokumente Publike⁹, Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Aksesit në Informacion iu dha autoriteti për të siguruar zbatimin e Ligjit për Akses në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e aksesit në dokumente publike.

Komisioneri për të Drejtën për Informim është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të ligjeve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Aksesin në Dokumente Publike si dhe për rregullimin e procedurave për ankesat administrative.

Më parë, Avokati i Popullit ndihmonte publikun në realizimin e të drejtës së tyre për qasje në dokumente publike sipas Kushtetutës¹⁰. Në vitin 2021, Avokati i Popullit mori 44 ankesa lidhur me qasjen në dokumente publike. Në vitin 2020 u morën gjithsej 62.

9 LIGJI_NO_06_L-081_PËR_QASJE_NË_DOKUMENTE_PUBLIKE.pdf (rks-gov.net)

10 Ligji no. 05 L-019 për Avokatin e Popullit – Institucioni i Avokatit të Popullit (oik-rks.org)

Të gjitha ankesat e marra nga Avokati i Popullit ishin për mospërgjigje ndaj kërkesave të autoriteteve publike apo refuzime të kërkesave.

Në vitin 2021 dhe 2022, Komisioneri i Agjencisë së Informim dhe Privatësi mori shumë më tepër ankesa për akses në dokumente publike sesa ishin marrë më parë nga Avokati i Popullit.


Agjencia i tha BIRN se kishte marrë shifrat e mëposhtme të ankesave nga qershori deri në dhjetor 2021:

Ankesa të marra	146
Të hapura/në shqyrtim	25
Të mbyllura	121

Ankesa të marra nga Komisioneri në vitin 2021.

Që nga emërimi i Komisionerit në qershor 2021 deri në fund të vitit, nuk u vendos asnjë gjobë. Siç tregon tabela e mësipërme, nga **146** ankesa të marra, **121** raste u mbyllën dhe u sigurua qasje e plotë në dokumentet e kërkuara. Vetëm **25** çështje mbeten të hapura dhe janë në shqyrtim nga Komisioneri. BIRN do të vazhdojë të monitorojë progresin e Komisionerit në qasjen në dokumente publike nga institucione të ndryshme në Kosovë.

Në vitin 2022 numri i ankesave u rrit në mënyrë drastike (me 196%). Deri në fund të nëntorit 2022, një total prej **383** ankesash u morën nga OJQ, përfaqësues të mediave dhe individë. Nga totali i ankesave, **87** ishin ende në shqyrtim dhe **296** të tjerat ishin mbyllur (me vendim). U vendosën **katër** gjoba.



Ankesat e marra nga Komisioneri (Janar-dhjetor 2022)

Komisioneri tha për BIRN se në 80% të rasteve, institucionet publike lejojnë qasje të plotë në dokumente publike dhe zakonisht nuk japin arsyetimin e duhur ligjor për refuzimin ose mungesën e përgjigjes së tyre. Komisioneri sugjeroi gjithashtu që ligji aktual të ndryshohet dhe të shkurtohet afati ligjor për dhënien e një vendimi. Komisioneri argumentoi se informacioni publik duhet të jetë i disponueshëm në internet, por se nevojitet vullnet politik për ta bërë këtë.

Komisioni Evropian vuri në dukje në raportin e progresit për Kosovën se përkundër burimeve të kufizuara njerëzore “Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik vazhdon të përpunojë ankesat për qasje në dokumente publike dhe për mbrojtjen e të dhënave në mënyrë të pavarur dhe efikase”.¹¹

MALI I ZI

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacion është mbikëqyrëse e Ligjit për Qasje në Informacione Publike në Mal të Zi. Agjencia ka rolin e një autoriteti mbikëqyrës siç parashikohet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është autonome dhe e pavarur. Ajo gëzon

11 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, Kosova 2022

statusin e personit juridik.¹²

Sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2022, “informacionet e klasifikuara nga institucionet publike dhe mbajtja e tyre nga publiku mbeten një problem” në Mal të Zi.¹³

Sipas të njëjtit raport, ndryshimet në Ligjin për Qasjen e Lirë në Informacion, të cilat synojnë të rrisin transparencën në punën e organeve publike dhe t’u japin qytetarëve malazezë qasje më të lehtë në informacion, duhet të miratohen ende nga parlamenti. Në tetor 2021, u miratuan ndryshime ligjore që mundësonin vendosjen e gjobave nëse aksesin në informacion nuk jepet siç duhet. Por ligji nuk është zbatuar plotësisht që atëherë për të vendosur gjopa kur aksesin në informacion nuk jepet siç duhet.

Në dhjetor 2021, projekt-amendamente në Ligjin për Qasje në Informacion u propozuan nga qeveria, por presin miratim nga parlamenti. Është ngritur një grup pune për të hartuar udhëzime për publikimin proaktiv të informacionit në faqet e internetit të institucioneve publike. Këta hapa duhet të hapin rrugën për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve publike ndaj qytetarëve malazezë. Në vitin 2021 u paraqitën 5,285 ankesa për akses të lirë në informacion (në vitin 2020 shifra ishte 4,328) dhe 351 ankesa (8.57%) u refuzuan nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si të pabazuara, ndërsa 4,095 ankesa u shqyrtuan.


BIRN u përpoq të kontaktonte disa herë Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por nuk mori përgjigje për numrin e ankesave të marra gjatë vitit 2022. Faqja e saj në internet nuk është përditësuar dhe nuk përfshin asnjë raport vjetor apo të dhëna aktuale.

Maqedonia e Veriut

12 Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacion (azlp.me)

13 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, Mali i Zi 2022

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione Publike është mbrojtësja e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione Publike në Maqedoninë e Veriut. Në vitin 2022, Agjencia papritur mori vetëm **343** ankesa, një e treta më pak se në dy vitet e mëparshme, dhe shumica ishin **për përgjigje të pasakta ndaj kërkesave** (210); disa ishin për mungesë të përgjigjeve ndaj kërkesave (rreth 92), dhe rreth 41 ishin për **refuzim të kërkesave**.¹⁴



Ankesat e marra nga Komisioneri në Maqedoninë e Veriut

Bazuar në të dhënat paraprake që BIRN mori nga Komisioni, shumica e ankesave u dorëzuan nga **persona juridikë**, për shembull nga shoqata të qytetarëve dhe fondacione (195), dhe **148** ankesa u paraqitën nga **individë**.

Megjithatë, në vitin 2021 numri i ankesave ishte shumë më i lartë, madje edhe më i lartë në vitin e mëparshëm (2020). Agjencia për Mbrojtjen e Qasjes së Lirë në Informacione Publike mori 798 ankesa në vitin 2021, nga të cilat 608 ishin kryesisht nga organizata të shoqërisë civile, ndërsa 190 ankesa u paraqitën nga individë.

Nga gjithsej 343 ankesa të marra gjatë vitit 2022, 210 ankesa (ose 61%) u

14 Të dhëna paraprake të marra nga BIRN nga Komisioneri

paraqitën për shkak të mungesës së përgjigjes ndaj kërkesave, e cila mbetet një sfidë e madhe dhe duhet të trajtohet në mënyrë aktive pasi nuk lejohet sipas ligjeve apo kushtetutës së vendit.

Sa i përket autoriteteve publike kundër të cilave ishin ankesat, Agjencia vërejtí se shumica e ankesave (16) u paraqitën kundër Ministrisë së Shëndetësisë. Nga komunat, komuna e Ohrit tërhoqi më shumë ankesa. Agjencia ende nuk ka vepruar për 25 ankesa për shkak se është bërë një ankesë e dytë nga paditësit. Ndaj zyrtarëve të cilët nuk veprojnë sipas vendimeve të Agjencisë, janë nisur procedura për shkelje. Raporti vjetor i ardhshëm i Agjencisë për vitin 2022 do të zbulojë detaje më specifike për institucionet që kanë qenë objekt ankesash.

Në vitin 2022 nuk pati ndryshime ligjore në Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione Publike.

SERBI

Në Serbi, kujdestari i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Rëndësi Publike është Komisioneri për Informacionin me Rëndësi Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Serbia ishte e vetmja që ndryshoi Ligjin e saj për Qasje të Lirë në Informacione me Rëndësi Publike vitin e kaluar. Megjithatë, ndryshimet nuk “i detyrojnë” institucionet publike të bëhen më transparente.

Ndryshimet, të cilat synojnë të rregullojnë më mirë qasjen e lirë në informacione me rëndësi publike, duhet të mundësojnë ushtrimin më të lehtë, më të shpejtë dhe më efikas të kësaj të drejte, duke penguar edhe çdo abuzim të kësaj të drejte.¹⁵

Kompetencat e Komisionerit për Informacionin me Rëndësi Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndahen në dy fusha: mbrojtja e së drejtës së qasjes së lirë në informacione me rëndësi publike, në përputhje me ligjin, dhe

15 Raporti Vjetor i Komisionerit për 2021

mbrojtja e të dhënave personale dhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.¹⁶

Ndryshimet në ligj gjithashtu zgjeruan ndjeshëm kompetencat e Komisionerit, duke i dhënë atij mundësinë për të paraqitur kërkesa për nisjen e procedurave të shkeljes dhe për të nxjerrë një urdhër kundërvajtje për shkelje të ligjit. Numri i autoriteteve që i nënshtrohen detyrimeve ligjore është rritur gjithashtu; procedura për kërkimin e informacionit të klasifikuar është rregulluar më hollësisht, si dhe është vendosur për përmbajtje të re për buletinet e detyrueshme për punën e organeve qeveritare. Efektet e këtyre ndryshimeve duhet të fillojnë të reflektohen, shpresojmë, gjatë këtij viti.

Megjithatë, vazhdon të jetë praktikë e zakonshme në Serbi që, në shumë raste, autoritetet publike veprojnë për një kërkesë për të drejtë informimi dhe e japin informacionin vetëm pasi aplikuesi ka paraqitur një ankesë te Komisioneri dhe pasi Komisioneri ia dorëzon atë autoritetit për një deklaratë. Kjo çon në pezullimin e procedurës së ankimit, por në të njëjtën kohë çon në ndjekje të panevojshme të rastit nga ata që kërkojnë informacione dhe në përdorim të panevojshëm të burimeve publike dhe kohës së stafit në zyrën e Komisionerit për t'u marrë me ankesat. Praktika e dhënies së informacionit vetëm pasi mësohet për një ankesë tregon se nuk ka pasur arsye specifike për të mos vepruar për kërkesat që janë paraqitur dhe se zvarritja e procesit mund të ishte shmangur.

Sipas raportit vjetor të Komisionerit për vitin 2021, Komisioneri mori gjithsej 7,244 raste në lidhje me qasjen e lirë në informacione me rëndësi publike (krahasuar me 5,201 raste në 2020), 3,366 raste në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale (krahasuar me 2,952 në 2020), dhe gjithsej 1,611 raste që lidhen me të dyja fushat (krahasuar me 1,065) në 2020. U pranuan gjithsej 12,221 raste, 3,003 më shumë se në vitin 2020. Ndërkohë në vitin 2021 u zgjidhën gjithsej 12,210 raste, 2,713 raste më shumë se në vitin 2020.

16 Raporti Vjetor i Komisionerit për 2020

Për vitin 2022, BIRN nuk mundi të merrte asnjë të dhënë paraprake nga zyra e Komisionerit, pasi ajo nuk iu përgjigj thirrjeve dhe raporti i saj vjetor për vitin 2022 ende nuk është publikuar.

Partneriteti për Qeverisje

të Hapur

Partneriteti për Qeverisje të Hapur, një nismë shumëpalëshe me bazë në SHBA që promovon qeverisjen e hapur, ka thënë vazhdimisht se vullneti politik është çelësi për të bërë ligje për të drejtën për informim në Ballkanin Perëndimor.

Për të vlerësuar hapshmërinë e qeverisë në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi dhe përafrimin e tyre me PQH, BIRN analizoi planet e veprimit dhe raportet e vetëvlerësimit mbi këtë çështje.

PQH-ja synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë kombëtare dhe nënkombëtare për të promovuar qeverisjen e hapur, për të fuqizuar qytetarët, për të luftuar korrupsionin dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për të forcuar qeverisjen.

Nëpërmjet PQH-së, qeveritë duhet të punojnë së bashku me shoqërinë civile për të bashkë-krijuar plane veprimi dyvjeçare me hapa dhe angazhime konkrete, për një gamë të gjerë çështjesh. Më pas, si pjesë e planit të tyre të veprimit, ato duhet të vendosin për reformat që mund të sjellin rezultate reale. Më e rëndësishmja, përpara se të përfundojë një plan veprimi, PQH-ja ka një Mekanizëm të Pavarur Raportues, MPR, i cili monitoron të gjitha planet e veprimit gjatë cikleve të tyre dyvjeçare, në mënyrë që të matë progresin në angazhimet e përcaktuara.

Për ciklin e raportimit 2020-2022, vetëm Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë publikuar planet e tyre kombëtare të veprimit. Bosnja dhe Hercegovina nuk ka publikuar raportin e saj të vetëvlerësimit në fund të afatit për planin më të fundit kombëtar të veprimit (për 2018-2021). Vetëm Mali i Zi ka publikuar deri më tani raportin e vetëvlerësimit të fundit të ciklit (në janar 2022).

Kosova është i vetmi vend nga rajoni që ende nuk i është bashkuar kësaj nisme, edhe pse ka shpresa se vendi do t'i bashkohet. Në faqen e internetit të Nismës për Partneritet për Qeverisje të Hapur, thuhet se në qershor të vitit 2021 qeveria e Kosovës edhe një herë mori vendimin për të filluar nismën për anëtarësim në PQH.¹⁷ Në tetor 2021, Kosova inauguroi Komitetin Koordinues Kombëtar për të udhëhequr procesin e anëtarësimit për t'iu bashkuar PQH-së.¹⁸ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Kosovës është caktuar për të koordinuar dhe nxitur nismën kombëtare.

Plani i veprimit i Shqipërisë 2020–2022 është plani i pestë i veprimit i PQH-së në vend. Ai përmban nëntë angazhime, të cilat synojnë të zhvillojnë plane integriteti, një regjistër të pronësisë përfituese, të përmirësojnë dhe digjitalizojnë ofrimin e shërbimeve publike, të publikojnë të dhëna të hapura, të zgjerojnë masat që sigurojnë akses në drejtësi dhe të zbatojnë transparencën buxhetore dhe transparencën e aseteve dhe të ardhurave shtetërore.

Sipas PQH-së, procesi i zhvillimit të planit të veprimit të Shqipërisë 2020–2022 u përball me mungesën e vazhdueshme të një forumi apo hapësire për qeverinë dhe shoqërinë civile për të mbikëqyrur bashkërisht procesin e zhvillimit, për të vendosur prioritetet dhe për të zgjedhur angazhimet përfundimtare.¹⁹

Shqipëria përmendi disa fusha mbi të cilat bazoi angazhimet e saj në planin e saj të pestë kombëtar të veprimit (2020-2022)²⁰: **Anti Korrupsioni** (Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë); **Qeverisja Digjitale** (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara Shqipëri); **Akresi në Drejtësi** (Ministria e Drejtësisë) dhe **Transparenca Fiskale** (Ministria e Financave dhe Ekonomisë). Ajo ende nuk e ka publikuar planin e saj të gjashtë kombëtar të veprimit.

17 Kreu – Partneriteti për Qeverisje të Hapur Nisma Kosovë

18 Inaugurimi i Komitetit Kombëtar të Koordinimit si pjesë e Partneritetit për Qeverisje të Hapur – Ministria e Qeverisjes Lokale Kosovë

19 Rishikimi i Planit të Veprimit Shqipëri 2020-2022

20 Plani i Veprimit Shqipëri 2020-2022

Megjithatë, sipas Mekanizmit të Pavarur të Raportimit (MPR) të PQH -së, në Rishikimin e Planit të Veprimit të MPR-së, “angazhimet në planin e veprimit 2020–2022, janë përsëritur kryesisht nga nisma dhe strategji para-ekzistuese të qeverisë, në vend që të rrjedhin nga prioritetet e identifikuara përmes angazhimi me shoqërinë civile dhe qytetarët. Për më tepër, meqenëse angazhimet vazhdojnë me reformat e para-planifikuara ose në vazhdim, disa çështje të rëndësishme janë zbatuar tashmë përpara se të fillonte konsultimi i planit të veprimit.”

Sipas rishikimit të MPR -së, mbetet e paqartë nëse angazhimet e përcaktuara të Shqipërisë synojnë vazhdimin e praktikave të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin, kërkesat ose politikat ekzistuese. Në fund të vitit 2022, qeveria e Shqipërisë gjithashtu duhej t’i dorëzonte PQH-së një vetëvlerësim të angazhimeve të përmbushura dhe të mënyrës së vlerësimit të tyre. Deri më tani, kjo nuk është bërë.

Struktura komplekse institucionale dhe sistemi politik i **Bosnjës dhe Hercegovinës** ka ndikuar në angazhimin e saj me PQH-në që nga viti 2014. Ajo më në fund zhvilloi planin e dytë të veprimit për periudhën 2022-2024.

Plani i ri i veprimit përfshin parimet e transparencës, luftimit të korrupsionit, fuqizimit të qytetarëve dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja për t’u mundësuar të gjitha autoriteteve publike të bëhen më efikase dhe më të përgjegjshme, si dhe të krijojnë parakushtet për menaxhim më efikas dhe inovativ të burimeve publike.²¹

Megjithëse plani i veprimit e angazhon Bosnjën të përmirësojë transparencën dhe aksesin në të dhënat e prokurimit, nevojiten masa për të forcuar monitorimin dhe sanksione për të parandaluar dhe trajtuar korrupsionin në prokurimin publik.

Bosnja përfundimisht realizoi raportin e saj të parë të vetëvlerësimit (2019-2021).

Bazuar në raport, institucionet publike kanë përmbushur pjesërisht disa nga zotimet, ndonëse me shumë vështirësi teknike. Megjithatë, vlerësimi vuri në dukje se vazhdon të ketë sfida në drejtim të forcimit të integritetit institucional, menaxhimit më efikas të burimeve publike, përmirësimit të shërbimeve publike përmes aplikimit të të dhënave të hapura, rritjes së transparencës së institucioneve dhe përmirësimit të bashkëpunimit dhe përfshirjes më të madhe të shoqërisë civile në politikëbërje.

Sipas raportit të MPR-së, Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës vazhdon të shprehë gatishmërinë e tij për të mbështetur dhe promovuar masat që do të çojnë në një zbulim më proaktiv të informacionit në faqet e internetit të institucioneve dhe në përmbushjen e standardeve të transparencës proaktive, të dhënave të hapura në fushën e statistikave dhe prokurimit publik, ndërtimin e një platforme ueb për hartimin e planeve të integritetit institucional të Bosnjës dhe Hercegovinës, vënien e buxhetit në dispozicion të publikut duke e publikuar atë online dhe ngritjen e mekanizmave efektivë të bashkëpunimit me shoqërinë civile.²²

Në janar 2023, Bosnja dhe Hercegovina publikoi planin e saj të dytë kombëtar të veprimit (2022-2024) dhe renditi dhjetë angazhime. Këto angazhime janë për të **Dhënat e Hapura** (Zhvillimi i Ekosistemit, Disponueshmëria dhe Përdorimi i të Dhënave Statistike), **Antikorrupsioni dhe Integriteti** (Transparenca Proaktive, Të Dhënat e Hapura për Prokurimin Publik; Krijimi i një Platforme Elektronike Kundër Korrupsionit; Digjitalizimi i Planeve të Integritetit dhe Regjistrave të Rrezikut.) dhe **Hapja Fiskale** (Përmirësimi i Transparencës Buxhetore), **Hapësira Qytetare** (Transparenca e Medias) dhe **Gjinia** (Transparenca e Informacionit për Barazinë Gjinore).²³

Mali i Zi sapo ka publikuar planin e ri kombëtar të veprimit për 2023-2024 dhe ka vendosur 20 angazhime të reja në fushat e pjesëmarrjes së publikut, të dhënave të hapura, aksesit në informacion, mbrojtjes së sinjalizuesve, transparencës

22 Vlerësimi i Planit të Veprimit për Bosnjën dhe Hercegovinën 2019-2021

23 Plani i Veprimit Bosnje dhe Hercegovinë 2022-2024

fiskale dhe qeverisjes së hapur në nivel lokal.²⁴

Megjithatë, raporti i përkohshëm i Mekanizmit të Pavarur Raportues për progresin e Malit të Zi për periudhën 2018-2021 tregonte se vendi pati vetëm sukses të kufizuar në zbatimin e detyrimeve që kishte marrë. Pati zbatim të kufizuar të pesë obligimeve dhe një tjetër nuk ishte nisur.

Megjithëse Plani i dytë i Veprimit i vendit (2018-2021) përfshinte aktivitete në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në internet, aksesin në informacion dhe transparencën buxhetore, të cilat kishin potencialin të kishin një impakt, zbatimi i tyre i kufizuar i pengoi ata të arrinin rezultate të dukshme ose ndryshime në praktikat e qeverisjes së hapur.²⁵

Sipas raportit të MPR-së për planin e veprimit 2018-2021, ky plan i dytë veprimi i dha fund një periudhe të zgjatur të pasivitetit të PQH-së në vend. Plani trajtonte transparencën buxhetore, pjesëmarrjen e publikut dhe shërbimet elektronike. Shumica e angazhimeve rrjedhin nga reforma e vazhdueshme e administratës publike të vendit dhe procesi i anëtarësimit në BE. Duke ecur përpara, Mali i Zi duhet të përdorë procesin PQH-së për të avancuar qëllimet strategjike afatgjata dhe për të forcuar transparencën në shpenzimet publike, aksesin në informacion dhe mjetet e pjesëmarrjes publike, tha MPR-ja.²⁶

Plani i ri kombëtar i veprimit i **Maqedonisë së Veriut** (2021-2023) përmban 40 zotime.²⁷ Plani i pestë i veprimit përmban një spektër shumë të gjerë angazhimesh lidhur me antikorrupsionin, aksesin në drejtësi, ofrimin e shërbimeve publike, drejtësinë e hapur, parlamentin e hapur, prokurimin publik, pronësinë përfituese, aksesin në informacion, të dhënat e hapura, mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

24 Plani Kombëtar i Veprimit Mali i Zi 2023-2024

25 Plani Kombëtar i Veprimit i Malit të Zi për 2023-2024

26 Mekanizmi i Pavarur i Raportimit i Malit të Zi 2018-2020

27 Plani Kombëtar i Veprimit Maqedonia e Veriut 2021-2023

Sipas raportit të rishikimit të MPR-së për planin e katërt të veprimit (2018-2020), nga 23 zotime, 12 kanë pasur zbatim “substancial”, ndërsa katër janë shënuar si “të përfunduara”. Në krahasim me këtë, në planin e tretë të veprimit (2016-2018), nga gjithsej 33 zotime, pesë ishin përfunduar plotësisht dhe 13 ishin përfunduar në mënyrë substanciale.²⁸

Për shkak të shtrirjes së madhe të planit të pestë të veprimit (2021-2023) nevojitet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të arritur rezultate të mira, thuhet në raportin e rishikimit të MPR-së.²⁹

Megjithatë, MPR-ja rekomandoi specifikimin e hapave më konkretë që duhet të ndërmerren dhe rezultate më specifike nga procesi i zbatimit. Për të zbatuar plotësisht angazhimet e përcaktuara, grupet e shoqërisë civile theksuan në raportin e MPR-së se mund të nevojiten burime shtesë njerëzore dhe financiare në institucionet publike (pesë temat e planit të veprimit janë: fokusimi te transparenca, anti-korrupsioni, ofrimi i shërbimeve publike, aksesit në drejtësisë, mjedisi dhe klima).

Maqedonia e Veriut ende nuk e ka publikuar raportin e vetëvlerësimit.

Plani i katërt kombëtar i veprimit i **Serbisë** (2020–2022) trajtoi fusha të ndryshme politikash (ndërtimi i kapaciteteve, pjesëmarrja publike, burimet natyrore, ofrimi i shërbimeve publike, anti-korrupsioni dhe integriteti dhe qeverisja elektronike) dhe angazhimet e tij synojnë të informojnë dhe angazhojnë më mirë publikun për çështje të ngutshme kombëtare.³⁰ Plani i veprimit (2020-2022) përmbante 12 angazhime që fokusoheshin në mundësimin e monitorimit dhe pjesëmarrjes më të mirë të publikut në hartimin e politikave dhe përmirësimin e aksesit në informacion dhe llogaridhënie publike.

28 Mekanizmi i Pavarur i Raportimit Maqedonia e Veriut 2018-2020

29 Mekanizmi i Pavarur i Raportimit Maqedonia e Veriut 2021-2023

30 Rishikimi i Planit të Veprimit të Serbisë 2020-2022

Megjithatë, PQH-ja tha se është e shqetësuar që ambicia e përgjithshme e planit të veprimit është e ulët, në një nivel me planet e mëparshme. MPR-ja rekomandoi forcimin e planeve të veprimit në të ardhmen duke përfshirë pikat më të rëndësishme të arritjeve, të cilat në mënyrë efektive përdorin njëra-tjetrën për të arritur qëllimet e deklaruara. Ajo rekomandoi gjithashtu integrimin më të përshtatshëm të nëpunësve publikë të nivelit më të lartë në të gjithë procesin e PQH-së në vend, në mënyrë që prioritetet e përzgjedhura të integrohen më mirë me prioritetet e qeverisë dhe të trajtohen më në thellësi.

Për më tepër, raporti i rishikimit të MPR-së vuri në dukje se “në përgjithësi, plani i veprimit nuk përfshin fusha të reja të politikave dhe mbart pesë tema nga plani i mëparshëm i veprimit, duke përfshirë aksesin në informacion, pjesëmarrjen qytetare, mjedisin dhe klimën, prokurimin publik dhe ofrimin e shërbimeve publike”.³¹

Në përgjithësi, të pesë vendet po luftojnë për të zbatuar plotësisht angazhimet e tyre të përcaktuara. Ata vazhdojnë të vendosin angazhime të larta, me detyra jo aq të qarta zbatimimi apo pika veprimi. Për të realizuar angazhimet, çdo vend duhet të caktojë ekipe më të vogla (shumëfunktionale nga jo më shumë se dy institucione të nivelit shtetëror) dhe të sigurojë dorëzimin në kohë të vlerësimeve të vendit dhe planeve të ardhshme të veprimit. Shtetet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht Bosnja dhe Hercegovina, dihet se përgjigjen me vonesë.

Përfundime

Ligjet për të Drejtën për Informim në Ballkanin Perëndimor priren të bëjnë regres për sa i përket transparencës. Reformat ligjore të planifikuara për ligjet për DI duket se janë të projektuara në një mënyrë që do të ishte e pamundur që gazetarët të mbanin përgjegjës autoritetet.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e legjislacionit për DI, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mbetur prapa në mënyrë të konsiderueshme. Ata vazhdojnë të kritikohen nga organizatat dhe ekspertët ndërkombëtarë të medias për mungesën e vullnetit politik kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve për DI dhe zbulimin e dokumenteve publike.

Bazuar në rekomandimet vjetore nga raportet e progresit të Komisionit Evropian dhe ekspertët e DI-së, ligjet për DI janë ndryshuar disa herë dhe shpresohet që ndryshimet e reja do t'i bënin institucionet më transparente. Megjithatë, në Bosnje dhe Hercegovinë, ndryshimet e reja të legjislacionit u diskutuan “me dyer të mbyllura” dhe doli se mbronin interesat private dhe jo interesin publik. Ndryshimet reduktuan afatin ligjor për të marrë një përgjigje zyrtare nga institucionet publike pas dorëzimit të një kërkesë për të drejtë informimi nga 15 në tetë ditë pune.

Amendamentet e ligjit në Bosnje dhe Hercegovinë favorizuan gjithashtu refuzimet e kërkesave për DI në vend që të ishin pro transparencës. Gazetarët dhe ekspertët boshnjakë të medias paralajmërojnë se amendamentet e ligjit mund të kthejnë pas kohën për sa i takon të Drejtës për Informim në vend. Ana pozitive e ligjit të ri është se ai kërkon krijimin e një baze të dhënash unike e cila të shërbejë si një regjistër informacioni publik dhe kërkon që çdo institucion i nivelit shtetëror të ketë një zyrtar komunikimi përgjegjës ekskluzivisht për të DI-të.

Në Serbi, amendamentet e reja e forcuan rolin e Komisionerit duke mundësuar vendosjen e gjobave për mospërgjigje ndaj kërkesave për DI. Deri më tani, shumë institucione publike në Serbi preferonin të mos u përgjigjeshin kërkesave për DI dhe do të përgjigjeshin vetëm nëse merrnin një shënim nga Komisioneri, edhe pse shpesh vetëm pjesërisht. Megjithatë, nuk është e qartë nëse gjobat e reja do të përmirësojnë apo jo reagimin e institucioneve publike.

Në përgjithësi, mekanizmat monitorues të vendosur, zyra e Komisionerit dhe ajo e Avokatit të Popullit, vazhdojnë të trajtojnë një numër të madh ankesash dhe vazhdojnë të ndjekin autoritetet publike për përgjigje dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për detyrimet e tyre ligjore në lidhje me të drejtën për informim. Megjithatë, gazetarët dhe përfaqësuesit e mediave përballesh me afate dhe nuk mund të presin për periudha të gjata që institucionet të përmbushin detyrat e tyre ligjore dhe të lejojnë akses të plotë në të dhënat e tyre publike.

Kur bëhet fjalë për përvojën e gazetarëve të BIRN, padyshim duket se situata në sferën e të drejtës për informim ka ndryshuar, por për keq. Ndërsa në vitin 2020, 40% e kërkesave të BIRN morën përgjigje të plota dhe 57% në 2021, në vitin 2022 kjo shifër ra në pikën më të ulët - 36%. Situata duket gjithashtu mjaft e ngjashme kur hedhim një vështrim te kërkesat për të drejtë informimi pa përgjigje: nga 45% në 2020 dhe 31% në 2021 në pikën më të ulët në 2022 - 57 për qind. Të gjitha institucionet publike që morën një kërkesë për të drejtë informimi nga BIRN në vitin 2022, u monitoruan në bazë të përgjigjes së dhënë, kohës që u duhej për t'u përgjigjur (nëse kishin përmbushur afatin ligjor) dhe nëse komunikimi ishte elektronik (më i shpejtë) ose kërkonte dërgimin e një kopje e shtypur me postë (ose një nënshkrim të shkruar me dorë nga personi që kërkon informacionin).

Disa institucione siguruan qasje të plotë në disa kërkesa, por të njëjtat institucione nuk iu përgjigjën fare kërkesave të tjera. Për shembull, kur BIRN kërkoi nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Kosovë lista të plota të pajisjeve zyrtare që një ish-ministër i kabinetit dhe ish-zëvendësministër nuk i ktheu, si dhe një listë të plotë të shpërndarjes për pagesat stimuluese prej 100

eurosh të dhëna nga qeveria e Kosovës, të gjitha kërkesat morën përgjigje të plota. Megjithatë, e njëjta ministri, kur iu kërkua të jepte detaje për pagat bruto të punonjësve që marrin pagë nga buxheti i shtetit, u përgjigj vetëm me detaje të pjesshme. Kur kërkesat ishin të një rëndësie të lartë publike, si detajet e pagave të mësuesve që nuk janë në listën zyrtare të pagave apo detajet e paketës së rimëkëmbjes ekonomike të COVID-19, apo buxheti i ndarë për menaxhimin e COVID-19, ministria nuk dha asnjë përgjigje.

Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Shëndetësisë në Kosovë i dha përgjigje të plota disa kërkesave (lista e pajisjeve zyrtare të pakthyerë nga një ish-ministër i kabinetit; kontrata e vaksinës; faturat nga ekipi i ministrit për udhëtime zyrtare) dhe nuk iu përgjigj kërkesave të tjera (proceset e vaksinimit në pikat kufitare, rastet e variantit të ri të COVID-19 Omicron dhe numri i mjekëve të ricaktuar në Qendrën Mjekësore Komunale).

Në Serbi, Ministria e Brendshme në Serbi u përgjigj vetëm pjesërisht (në dy nga tre kërkesa). Kur BIRN kërkoi të dhëna për kontrabandistët nga Serbia dhe arrestimet e tyre, ajo thjesht lëshoi një dokument të nënshkruar që nuk ishte kërkuar dhe tha se për shkak të një hetimi në vazhdim nuk mund të përgjigje kur mori kërkesën. Megjithatë, u vu re një përmirësim i vogël. BIRN mori informacion të plotë për një kriminel luftarë në kërkim nga Ministria e Brendshme. Në vitin 2020, ajo refuzoi kërkesën e BIRN në disa raste dhe u përgjigj vetëm pasi Komisioneri e urdhëroi këtë gjë. Shpresojmë që kjo do të nënkuptojë që Ministria e Brendshme të mos citojë më shqetësimet e privatësisë ose konfidencialitetin si arsye për të mos zbuluar informacione rreth kriminelëve të dyshuar ose të dënuar të luftës.

Situata me kërkesat për DI është e ngjashme në Maqedoninë e Veriut. Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, i pyetur nga BIRN për të dhënë një listë të personave që kishin marrëveshje kontraktuale me qeverinë për vitin 2022, ai dha përgjigje të plota dhe në kohë. Por kur po kësaj zyre iu kërkua të jepte informacion për ndarjen e fondeve të marra në vitin 2020 dhe raportet vjetore për masat disiplinore dhe përgjegjësitë financiare të zyrtarëve

administrativë për vitin 2021, nuk u përgjigj.

Kur përiqemi të kuptojmë tendencat pas përgjigjeve të institucioneve publike ndaj kërkesave për DI në Ballkanin Perëndimor, është e qartë se kur ka vullnet politik në krye, institucionet i zbulojnë plotësisht dokumentet e kërkuara. Por, kur nuk ka vullnet politik, dhe edhe nëse koordinatorët e caktuar për DI janë të trajnuar dhe duhet të respektojnë plotësisht ligjin për kërkesat për DI, institucionet nuk përgjigjen dhe nuk japin asnjë informacion. Kur nuk janë të sigurt nëse informacioni mund të dëmtojë reputacionin e drejtuesit të institucionit, ata mund ta shënojnë atë si “të klasifikuar” pa ndonjë proces dhe procedurë të duhur ligjore për klasifikimin e dokumenteve. Në shumë raste, gazetarëve të BIRN iu është dashur të vazhdojnë të kontaktojnë me të njëjtin institucion për të marrë një dokument të vetëm, një proces që mund të zgjasë javë ose muaj. Ankesat në zyrat e Komisionerëve nuk garantojnë gjithmonë akses të plotë ose në kohën e duhur.

Ishte e dukshme që në vitin 2022, shumë institucione publike preferuan t’i mbanin të dhënat publike “sekret” dhe të mos kontribuonin për të ndihmuar publikun të kuptonte më mirë ngjarje të rëndësishme ose veprime qeveritare. Kjo ishte një vazhdimësi e asaj që ndodhi në vitet e mëparshme. Në vitin 2020 dhe në vitin 2021, shumë institucione gjithashtu thjesht i shpërfillën kërkesat e BIRN për DI. Edhe kur pati një ndërhyrje nga Komisioneri, nuk është siguruar gjithmonë akses i plotë në dokumentet e kërkuara, por vetëm akses i pjesshëm. Në përgjithësi, institucionet publike vazhdojnë të parashetrojnë kërkesa, jo gjithmonë në përputhje me legjislacionin për DI.

Vetëm në rastet kur pati ndryshim qeverie apo atmosfere politike pati respektim të kërkesave për DI. Për shembull, në Kosovë, zyra e presidentit filloi të përmbushë plotësisht kërkesat për DI të BIRN vetëm në vitin 2020, nën mandatin e presidentes aktuale. Më parë, për shumë vite, nuk ishte përmbushur asnjë kërkesë në zyrën e presidentit.

Kur nuk ka vullnet politik, ka pak përputhshmëri. Qeveria e Serbisë nuk iu përgjigj kërkesave të BIRN për DI në vitin 2020 apo në 2022.

Në anën tjetër, Ministria e Financave në Kosovë ka kaluar nga përgjigjet e plota në vitin 2020 (fatura shpenzimesh, vendime) në përgjigje të pjesshme ose asnjë përgjigje në vitin 2022 (listat e kërkuara të pagave bruto të punëtorëve që marrin paga nga buxheti i shtetit). Edhe në vitin 2021, ajo nuk u përgjigj, duke mos dhënë asnjë përgjigje (zbatimi i paketës së rimëkëmbjes ekonomike COVID-19 dhe paketës së ringjalljes ekonomike).

Ministria e Tregtisë në Serbi vazhdon të renditet më e ulëta përsa i takon transparencës për kërkesat për Di. Në vitin 2020, ajo u përgjigj vetëm pjesërisht (eksportet e armëve). Megjithatë, në vitin 2021 (eksportet e armëve Zastava në Afrikë) dhe në 2022 (eksportet e armëve në Ukrainë dhe Shtetet e Bashkuara), ministria nuk dha asnjë përgjigje.

Në mënyrë domethënëse, kur ka një krizë të madhe, institucionet gjithashtu preferojnë të mos përgjigjen. Në vitin 2022, kur autoriteteve në Kosovë (Kuvendi dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve), Maqedoninë e Veriut (Ministria e Shëndetësisë) dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (Ministria e Shëndetësisë) iu kërkuar nga BIRN të jepnin detaje mbi rregulloret aktuale të COVID-19, statistikat e infektiveve, dokumentet e tenderit të vaksinave apo paketat ekonomike, ata nuk u përgjigjën fare, edhe pse çështjet ishin me interes të lartë publik.

Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2021, kur BIRN u kërkoi autoriteteve publike në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (Ministritë e Shëndetësisë) të zbulonin disa rregullore të vaksinimit kundër COVID-19 dhe aplikacionet e përdorura për të kontaktuar qytetarët, ata nuk u përgjigjën fare. Edhe më keq, kur Qeverisë së Federatës në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Institutit të Shëndetit Publik në Bosnjë dhe Hercegovinë iu kërkuar nga BIRN në vitin 2021 të publikonin kontratat e prokurimit të vaksinës COVID-19, ata thjesht i refuzuan kërkesat. Përgjigja e tyre e vetme ishte se dokumentet ishin “konfidenciale”, pa përmendur ndonjë

arsyetim të duhur ligjor.

Në vitin 2020, situata nuk ishte ndryshe. Qeveria e Serbisë dhe Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, kur iu kërkua nga BIRN të zbulonin disa rregullore apo përditësime statistikore për COVID-19, nuk u përgjigjën fare. Vetëm Instituti i Shëndetit Publik në Serbi u përgjigj pjesërisht kur iu kërkua të publikonte të dhëna të lidhura me COVID-19.

Në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, të njëjtat probleme vazhdojnë të përsëriten. Edhe pse ligjet po amendohen, sfidat e përditshme me të cilat përballen gazetarët e BIRN, ekspertët e medias dhe organizatat ndërkombëtare tregojnë se po shfaqen një numër në rritje “kufizimesh”.

Më saktësisht, institucionet po përpiqen ta ndryshojnë ligjin “siç e shohin të arsyeshme” për t’i dhënë vetes mundësinë për të mos iu përgjigjur kërkesave për DI dhe për të minimizuar zbulimin e plotë të të dhënave publike.

Institucionet e nivelit shtetëror po kërkojnë ligje të reja problematike për të drejtën për informim që nuk do të jenë pro transparencës dhe proaktivitetit. Në Bosnje dhe Hercegovinë, gazetarët pretendojnë se një projektligj për të drejtën për informim do të zgjerojë ndjeshëm kufizimet në informacionin që mund të publikohet.³² Në Shqipëri, reformat e planifikuara të ligjit për të drejtë informimi duket se janë të dizajnuara për ta bërë të pamundur që gazetarët ta mbajnë përgjegjës pushtetin.³³ Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, në Kosovë, ekspertët e medias kanë ngritur shqetësime se presioni politik, fushatat e shpifjeve dhe mungesa e transparencës po minojnë progresin e Kosovës në përmirësimin e mjedisit mediatic.³⁴

32 Shqetësime Transparence në Bosnje për Ligjet e reja për DI

33 Shtytja e Shqipërisë për të Bllokuar kërkesat “Abuzive” për DI Kritikohet

34 Liria e Medias në Kosovë “Minohet nga Presioni Politik”

Rekomandime

- Të gjitha institucionet publike duhet të trajnohen për ligjet për të Drejtën e Informimit dhe të mësohen se çfarë është një dokument i klasifikuar dhe si mund të publikohet gjithsesi me redaktime sa më minimale. Ata duhet t'i vënë të dhënat në dispozicion në internet dhe t'i publikojnë ato rregullisht.
- Të gjitha institucionet publike duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë rregullisht një bazë të dhënash elektronike për akses më të shpejtë dhe më të saktë në kërkesat.
- Të gjitha institucionet publike duhet të obligohen ligjërisht që të kenë të dhëna të hapura të postuara rregullisht në faqet e tyre të internetit.
- Ligji për Qasjen në Informacion për t'u dhënë më shumë pushtet Komisionerëve dhe për të forcuar burimet e tyre (njerëzore, financiare) në mënyrë që ata të mund të vazhdojnë të rrisin ndërgjegjësimin, të monitorojnë shkeljet, të aplikojnë sanksione (gjoba) dhe të garantojnë që nëpunësit publikë të trajnohen si duhet për t'u marrë me ligjet dhe rregulloret për të drejtë informimi.
- Asnjë kërkesë për të drejtë informimi nuk duhet të dorëzohet në një format të shtypur (me postë). Të gjitha institucionet publike duhet të përdorin më shumë praktika të digjitalizuara për dokumentet dhe metodat e dorëzimit të kërkesave për të drejtë informimi.
- Duhet të reduktohen afatet ligjore për t'iu përgjigjur kërkesave për të drejtë informimi dhe institucionet duhet të inkurajohen të komunikojnë nëpërmjet kanaleve elektronike.
- Secili institucion publik duhet të ketë një Zyrtar të emëruar dhe të trajnuar për të Drejtën për Informim dhe mbikëqyrësit e tyre duhet të trajnohen më mirë për ligjet për të drejtë informimi.

